



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 589/4 prot.

Datë 07.04.2023

V E N D I M
Nr. 263/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.04.2023 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertave të paraqitur nga operatorët ekonomikë “Krijon” SHPK, “Gamma” SHPK, “Isometric” SHPK dhe “Medfau” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-43070-09-23-2022, me objekt “Blerje pajisje laboratorit për Autoritetin Kombëtar të Ushqimit”, me fond limit 46,795,767 (dyzetë e gjashtë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH ose 401,198 (katërqind e një mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tetë) euro pa TVSH, kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 22.09.2022 është 116.64 lekë), zhvilluar në datën 12-12-2022 nga autoriteti kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Ankimues: Operatori ekonomik “Almedical” SHPK.
Adresa: Rruga “Shefqet Musaraj” Nd. 17, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.
Adresa: Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1, 1001, Tiranë.

Subjekte të interesuar: Operatori ekonomik “Medfau” SHPK.
Adresa: Lagjja Nr. 5. Kavajë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlëra limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 26.09.2022 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-43070-09-23-2022, me objekt “Blerje pajisje laborator për Autoritetin Kombëtar të Ushqimit”, me fond limit 46,795,767 (dyzetë e gjashtë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH ose 401,198 (katërqind e një mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tetë) euro pa TVSH, kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë

22.09.2022 është 116.64 lekë), zhvilluar në datën 12-12-2022 nga autoriteti kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

II.2. Në datë 12.12.2022 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit prokurimeve elektronike rezulton, se në datën 04.01.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Krijon” SHPK	26.789.000	leke	kualifikuar
2. “Gamma” SHPK	29.000.000	leke	kualifikuar
3. “Isometric” SHPK	29.028.300	leke	kualifikuar
4. “Medfau” SHPK	36.912.259.20	lekë	kualifikuar
5. “Almedical” SHPK	40.500.000	lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 12.01.2023 autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e Njoftim-Fituesit në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, ku për këtë procedurë prokurimi është shpallur fituese oferta e operatorit ekonomik “Krijon” SHPK

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 23.01.2023, operatori ekonomik ankimues “Almedical” SHPK, ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor ankesën nr. 121 prot, datë 23.01.2023 nëpërmjet së cilës kundërshton vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertave të operatorëve ekonomikë “Krijon” SHPK, “Gamma” SHPK, “Isometric” SHPK dhe “Medfau” SHPK.

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 dhe 4/c të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 121/2 prot., datë 24.01.2023, u publikuan kriteret e kualifikimit të cilat operatori ekonomik ankimues “Almedical” SHPK pretendon, se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë “Krijon” SHPK, “Gamma” SHPK, “Isometric” SHPK dhe “Medfau” SHPK.

II.7. Me shkresën nr. 26 prot., datën 25.01.2023, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me shkresën nr. 121/3 prot, datë 27.01.2023 është depozituar kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion të dokumenteve nga operatori ekonomik “Krijon” SHPK.

II.8. Me shkresën protokolluar me 121/4 prot., datën 30.01.2023, pranë Komisionit Prokurimit Publikme është depozituar kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion të dokumenteve nga operatori ekonomik “*Isometric*” SHPK.

II.9. Me shkresën nr. 123/4 prot., datën 02.02.2023, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me shkresën nr. 121/7 prot, datë 06.02.2023, është depozituar informacioni i autoritetit kontraktor, si dhe kthim-përgjigjja e operatorit ekonomik ankimues lidhur me trajtimin e ankesës së tij, në të cilën konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, ka vendosur mospranimin e ankesës.

II.10. Me shkresën nr. 121/8 prot, nr. 121/9 prot, nr. 121/10 prot, nr. 121/11 prot, datë 02.03.2023, me objekt: “*Kërkesë për informacion*”, Komisioni Prokurimit Publik i është drejtuar operatorëve ekonomikë “*Krijon*” SHPK, “*Gamma*” SHPK, “*Isometric*” SHPK dhe “*Medfau*” SHPK duke i kërkuar informacion me përmbajtje si vijon:

Në kuadër të shqyrtimit të ankesës së mësipërme, KPP shfaq vështirësi në evidentimin dhe verifikimin e specifikimeve teknike të artikujve nr. 20, 22 dhe 35 në katalogët e paraqitur nga ana juaj në sistemin elektronik të prokurimeve (SPE), (për të cilat operatori ekonomik ankimues “Almedical” SHPK) pretendon se nuk përmbushen specifikimet teknike për këto artikuj. Referuar sa më sipër, me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur dhe shqyrtimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, kërkojmë nga ana juaj të dorëzoni pranë KPP-së informacion prova dhe fakte se në cilën faqe apo paragrafë të katalogut, nga ato të dorëzuar nga ana juaj në Sistemin e Prokurimit Elektronik, gjenden specifikimet teknike. Përsa më sipër kërkojmë nga ana juaj të dorëzoni pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacionin e kërkuar, brenda datës 07.03.2023, ora 14:00.

II.11. Me datë 06.03.2023, protokolluar me tonën me shkresën nr. 121/12 prot, datë 06.03.2023, pranë Komisionit Prokurimit Publik ka depozituar informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar sipas shkresës së sipërcituar, operatori ekonomik “*Medfau*” SHPK.

II.12. Me shkresën nr 70017 prot, datë 06.03.2023, protokolluar me tonën me shkresën nr. 121/13 prot, datë 07.03.2023 pranë Komisionit Prokurimit Publik është depozituar (shkresa kthim përgjigje) e operatorit ekonomik “*Gamma*” SHPK me anë të së cilës refuzon të paraqesë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar nga Komisioni Prokurimit Publik me shkresën nr. 121/11 prot, datë 02.03.2023.

II.13. Me shkresën nr. 72 prot, datë 06.03.2023, protokolluar me tonën me shkresën nr. 121/14 prot, datë 07.03.2023 pranë Komisionit Prokurimit Publik, ka depozituar informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar sipas shkresës së sipërcituar operatori ekonomik “*Krijon*” SHPK.

II.14. Me datë 07.03.2023, protokolluar me tonën me shkresën nr. 121/15 prot, datë 07.03.2023 pranë Komisionit Prokurimit Publik ka depozituar informacioni dhe dokumentacionin e kërkuar sipas shkresës së sipërcituar operatori ekonomik “*Isometric*” SHPK.

II.15. Me shkresën nr. 121/16 prot, nr. 121/17 prot, nr. 121/18 prot, datë 13.03.2023, me objekt: “*Njoftim për seancë dëgjimore pranë Komisionit Prokurimit Publik*”, Komisioni Prokurimit Publik i është drejtuar operatorëve ekonomikë “*Krijon*” SHPK, “*Isometric*” SHPK dhe “*Medfau*” SHPK duke i kërkuar informacion me përmbajtje si vijon:

Operatori ekonomik “Almedical” SHPK, në ankesën e tij ka ngritur pretendime në lidhje me mospërmbushjen e specifikimeve teknike nga ana juaj për artikujt me nr. rendor 20, 22 dhe 35 në katalogët e paraqitur nga ana juaj në sistemin elektronik të prokurimeve (SPE),

Në kuadër të shqyrtimit të ankesës së mësipërme, KPP shfaq vështirësi në evidentimin dhe verifikimin në katalog të specifikimeve teknike për artikujt objekt ankese me nr. rendor 20, 22, 35 të dorëzuara nga ana juaj në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE).

Me qëllim gjykimin e ankesës të paraqitur, në zbatim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” si dhe nenit 23 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të nevojshëm zhvillimin e një seance dëgjimore në ambientet e institucionit tonë me përfaqësues nga operatori juaj ekonomikë, të paktën një përfaqësues, një përfaqësues nga autoriteti kontraktor pjesë e njësisë së prokurimit që është marrë me hartimin e kriterëve dhe specifikimeve teknike, dhe një përfaqësues të komisionit vlerësimit të ofertave për të bërë të mundur evidentimin dhe verifikimin e specifikimeve teknike të artikujve me nr. rendor 20, 22, 35 në katalogët e dorëzuara nga ana juaj si operator ekonomik në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE).

Seanca dëgjimore do të zhvillohet ditën e mërkurë, datë 15.03.2023, ora 11:30 operatori ekonomik “Medfau” SHPK; ditën e mërkurë, datë 15.03.2023, ora 12:00 operatori ekonomik “Isometric” SHPK; dhe ditën e mërkurë, datë 15.03.2023, ora 12:30 operatori ekonomik “Krijon” SHPK.

II.16. Në datën 15.03.2023, ora 11:30 në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik nuk u paraqitë asnjë përfaqësues i operatorit ekonomik “*Medfau*” SHPK për të mbajtur seancën dëgjimore ashtu sikurse ishte përcaktuar në shkresën e sipërcituar.

II.17. Në datën 15.02.2023, ora 12:00 në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik u mbajt seancë dëgjimore me përfaqësues të operatorit ekonomik “*Isometric*” SHPK dhe të autoritetit kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara, në prani të palëve të sipërcituara, në përgjigje të kërkesës së Komisionit të Prokurimit Publik për sqarim për zërat (artikujt) me nr. rendor 20-22-35, në tabelën e specifikimeve teknike të dokumenteve standarde të tenderit, për të cilat operatori ekonomik ankimes është skualifikuar me

pretendimin se këto zëra nuk plotësojnë specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

“Në prezencë të përfaqësuesve të autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik ankimes, KPP ndër të tjera, pyet:

KPP pyet OE: *Në cilën faqe të katalogut të ngarkuar në SPE nga ana juaj plotësohen specifikimet teknike për të cilat ngrihen pretendime nga operatori ekonomik ankimes për produktin me nr. rendor 20 HPLC With autosampler, DAD, konkretisht specifikimet:*

- 1- *Pompa duhet te kete degazues te integruar me të paktën 4 kanale*
- 2- *Diapazoni i prurjes: të paktën 0.001- 10mL/min*
- 3- *Precizioni $\leq 0.07\%$ RSD*
- 4- *Saktësia e prurjes të paktën $\pm 1\%$*
- 5- *Moduli të punojë me presion më shumë se 580 bar*
- 6- *Formimi i gradientit të bëhet me anë të përzjerjes në presion të ulët*
- 7- *Kontrolli i çdo përbërësi të prurjes të ketë diapazon 0-100%*
- 8- *Pompë Kuaternare me dual piston ne seri*
- 9- *Saktësia e përberjes së prurjes $< 0.2\%$ RSD*
- 10- *Kompensimi i shtypjes te kete mundesi per tu zgjedhur nga perdoruesi Ph i rekomanduar 1-12.5*
- 11- *Kapaciteti i autosamplerit >200 vialë nga 2 ml*
- 12- *Diapazoni i volumit të injektimit: 0.1-100uL*
- 13- *Carry Over: më pak se 0.003%*
- 14- *Moduli të punojë me presion deri në 800bar*
- 15- *Koha e ciklit të injektimit $<10s$*
- 16- *Preçizioni i injektimit më pak se 0.15% RSD*
- 17- *Moduli të ketë kapacitet për 4 kolona nga 300 mm*
- 18- *Diapazoni i temperaturës: $10^{\circ}C$ nën ambient deri ne $85^{\circ}C$*
- 19- *Me 2 zona temperature*
- 20- *Saktësia e temperaturës: $\pm 0.5^{\circ}C$*
- 21- *Stabiliteti i temperatures: $\pm 0.1^{\circ}C$ ose me i mire*
- 22- *Koha e ngrohjes: < 6 min nga ambienti ne $40^{\circ}C$*
- 23- *Moduli të vijë i shoqëruar me një valvul 2 pozicione / 6porta*

- 24- *Dedektori duhet të ketë qelize matje 10 mm*
- 25- *Diapazoni i gjatesise se vales 190-640 nm ose me mire*
- 26- *Zhurma për qelize matje 10mm më e vogël se $\pm 3.2 \times 10^{-6}$*
- 27- *Dedektori duhet të ketë 1024-elemente diode me 8 sinjale.*
- 28- *Data rate të jetë te pakten 120Hz per spektra dhe sinjalet.*
- 29- *Drifti me pak se 0.5×10^{-3} AU/h*
- 30- *Dedektori duhet të ketë mundesi identifikimi automatik për qelizen e prurjes dhe per llampen (RFID) Lineariteti me shume se 2 AU ne 265 nm*
- 31- *Softëare dhe aparatura e HPLC duhet të jetë nga i njëjti prodhues*

32- Një PC dhe printer duhet të kontrollojë të gjithë modulet dhe të bëjë procesimin e të dhënave si, identifikimin e pikut, analizimin e të dhënave, kalibrimin, kuantifikimin dhe raportimin/ose ekuivalenti këtyre të dhënave.

Përfaqësuesi i operatorit ekonomik z. N. C sqaron se: Specifikimi teknike për artikullin me nr rendor 20 HPLC Ëith autosampler, DAD, në katalogun e dorëzuar nga ana jonë në SPE me emërtesën Katalog Pajisje AKU P2 por dhe shpjegimet e paraqitura nga ana jonë sipas kërkesës tuaj evidentohen në këto faqe në katalog konkretisht:

1- Pompa duhet te kete degazues te integruar me të paktën 4 kanale, ky specifikim gjëndet në faqen 6, fjalia 2 të katalogut ku evidentohet nga 4 kanale ne kemi paraqitur me 5 kanale.

2- Diapazoni i prurjes: të paktën 0.001- 10mL/min, ky specifikim gjëndet në faqen 6 të katalogut fjalia 6.

3- Precizioni $\leq 0.07\%$ RSD, ky specifikim gjëndet në faqen 6 të katalogut, fjalia 8.

4- Saktësia e prurjes të paktën $\pm 1\%$, ky specifikim gjëndet në faqen 6 të katalogut fjalia 7, ku nga $\leq 0.07\%$ RSD, produkti ynë e ka $\leq 0.05\%$ RSD.

5- Moduli të punojë me presion më shumë se 580 bar, ky specifikim gjëndet në faqen 9 të katalogut fjalia 31, ku nga 580 bar, produkti ynë e ka 11600 psi, të cilën po ta konvertosh në bar si njësi matëse të kërkuar nga AK jep të njëjtin rezultat.

6- Formimi i gradientit të bëhet me anë të përzjerjes në presion të ulët Kontrolli i çdo përbërësi të prurjes të ketë diapazon 0-100%, ky specifikim gjëndet në faqen 6 të katalogut fjalia 16.

7- Pompë Kuaternare me dual piston ne seri, ky specifikim gjëndet në faqen 6 të katalogut fjalia 1 dhe 2.

8- Saktësia e përberjes së prurjes $< 0.2\%$ RSD, ky specifikim gjëndet në faqen 6 të katalogut fjalia 8, ku nga $\leq 0.2\%$ RSD, produkti ynë e ka $\leq 0.05\%$ RSD.

9- Kompensimi i shtypjes te kete mundesi per tu zgjedhur nga perdoruesi Ph i rekomanduar 1-12.5, ky specifikim gjëndet në faqen 6 të katalogut fjalia 18.

10- Kapaciteti i autosamplerit >200 viale nga 2 ml, ky specifikim gjëndet në faqen 9 të katalogut fjalia 18-19-20.

11- Diapazoni i volumit të injektimit: 0.1-100uL, ky specifikim gjëndet në faqen 9 të katalogut fjalia 22.

12- Carry Over: më pak se 0.003%, ky specifikim gjëndet në faqen 10 të katalogut fjalia 1.

13- Moduli të punojë me presion deri në 800 bar, ky specifikim gjëndet në faqen 9 të katalogut fjalia 31.

14- Koha e ciklit të injektimit $<10s$, ky specifikim gjëndet në faqen 9 të katalogut fjalia 26 dhe 28, ku nga $<10s$, produkti ynë e ka $<20s$.

15- Precizioni i injektimit më pak se 0.15% RSD, ky specifikim gjëndet në faqen 10 të katalogut fjalia 4.

16- Moduli të ketë kapacitet për 4 kolona nga 300 mm, ky specifikim gjëndet në faqen 8 të katalogut fjalia 22.

17- Diapazoni i temperaturës: $10^{\circ}C$ nën ambient deri ne $85^{\circ}C$, ky specifikim gjëndet në faqen 8 të katalogut fjalia 18.

18- Me 2 zona temperature, ky specifikim gjëndet në faqen 8 të katalogut fjalia 23.

19- Saktësia e temperaturës: $\pm 0.5^{\circ}C$, ky specifikim gjëndet në faqen 8 të katalogut fjalia 20, ku nga $\pm 0.5^{\circ}C$, produkti ynë e ka $\pm 0.3^{\circ}C$.

- 20- Stabiliteti i temperatures: $\pm 0.1^{\circ}\text{C}$ ose me i mire, ky specifikim gjëndet në faqen 8 të katalogut fjalë 19, ku nga $\pm 0.1^{\circ}\text{C}$, produkti ynë e ka $\pm 0.03^{\circ}\text{C}$.
- 21- Koha e ngrohjes: < 6 min nga ambienti ne 40°C , ky specifikim gjëndet në faqen 8 të katalogut fjalë 19, ku nga $\pm 0.1^{\circ}\text{C}$, produkti ynë e ka $\pm 0.03^{\circ}\text{C}$
- 22- Moduli të vijë i shoqëruar me një valvul 2 pozicione / 6porta, ky specifikim gjëndet në faqen 8 të katalogut fjalë 19, ku nga $\pm 0.1^{\circ}\text{C}$, produkti ynë e ka $\pm 0.03^{\circ}\text{C}$
- 23- Dedektori duhet të ketë qelize matje 10 mm, ky specifikim gjëndet në faqen 7 të katalogut fjalë 8.
- 24- Diapazoni i gjatesise se vales 190-640 nm ose me mire, ky specifikim gjëndet në faqen 7 të katalogut fjalë 5, ku nga 190-640nm, produkti ynë e ka 190-950.
- 25- Zhurma për qelize matje 10mm më e vogël se $\pm 3.2 \times 10^{-6}$, ky specifikim gjëndet në faqen 7, fjalë 13, të cilën po ta konvertosh del me vogël se vlera e kërkuar nga AK konkretisht $< \pm 1 \times 10^{-5}$.
- 26- Dedektori duhet të ketë 1024-elemente diode me 8 sinjale, ky specifikim gjëndet në faqen 7, fjalë 3 dhe 4.
- 27- Data rate të jetë te pakten 120Hz per spektra dhe sinjalet, ky specifikim gjëndet në faqen 7, fjalë 17 dhe 18. Aparati qe ne kemi ofertuar përbëhet nga 5 kanale ku konkretisht $5 \times 50 \text{ Hz} = 250 \text{ Hz}$, pra e përfshin edhe atë që ka kërkuar AK.
- 28- Drifti me pak se $0.5 \times 10^{-3} \text{ AU/h}$, ky specifikim gjëndet në faqen 7, fjalë 15, të cilën po ta konvertosh del me vogël se vlera e kërkuar nga AK konkretisht $0.2 \times 10^{-3} \text{ AU/h}$, duke përfshirë edhe specifikimin e AK.
- 29- Dedektori duhet të ketë mundesi identifikimi automatik për qelizen e prurjes dhe per llampen (RFID) Lineariteti me shume se 2 AU ne 265 nm, ky specifikim gjëndet në faqen 7, fjalë 14, duke e tejkualuar specifikimin e AK pasi saktësia 2AU fillon që në gjatësin spektrale më të ulët nga 254 nm ndërkohë AK ka kërkuar të fillojë 265 nm, duke e përfshirë dhe specifikimin e AK.
- 30- Softëare dhe aparatura e HPLC duhet të jetë nga i njëjti prodhues, ky specifikim gjëndet në faqen 5.
- 31- Një PC dhe printer duhet të kontrollojë të gjithë modulet dhe të bëjë procesimin e të dhënave si, identifikimin e pikut, analizimin e të dhënave, kalibrimin, kuantifikimin dhe raportimin/ose ekuivalenti këtyre të dhënave, ky specifikim gjëndet në faqen 10 dhe 11 pjesët e markuara të katalogut.

KPP pyet OE: Në cilën faqe të katalogut të ngarkuar në SPE nga ana juaj plotësohen specifikimet teknike për të cilat ngrihen pretendime nga operatori ekonomik ankimes për produktin me nr rendor 22 Kape Kimike, konkretisht specifikimet:

- 1- Gjerësia 1100 mm - 1200 mm,
- 2- Kapaciteti thithës mbi 1700 m³/ore
- 3- Syprina e punës me material antiacid
- 4- Suporti i jashtëm me strukture prej celiku te galvanizuar
- 5- Pajisur me lavaman me material celik inoks te integruar ne syprinën e punës
- 6- Pajisur me rubinet uji
- 7- Pajisur me te pakten 2 priza elektrike
- 8- Kabina duhet te kete ndricim

9-Pjesa ballore me xham sigurie te lëvizshëm, te laminuar te pakten 5mm

Përfaqësuesi i operatorit ekonomik z. N. C sqaron se: Specifikimi teknike për artikullin me nr rendor 22 Kapë Kimike, në katalogun e dorëzuar nga ana jonë në SPE me emërtesën Katalog Pajisje AKU P2 por dhe shpjegimet e paraqitura nga ana jonë sipas kërkesës tuaj evidentohen në këto faqe në katalog konkretisht:

1- Gjerësia 1100 mm - 1200 mm, ky specifikim gjëndet në faqen 16 të katalogut në tabelën e dimensioneve i markuar kodi përkatës VG-BS-1220.

2- Kapaciteti thithës mbi 1700 m³/ore, ky specifikim gjëndet në faqen 16, fjalia dytë tek paragrafi technical features. Aparati qe ne kemi ofertuar tejklon specifikimet teknike të kërkuara nga AK pasi kapaciteti thithës fillon nga 420 m/h dhe shkon deri në 4500 m³/h.

3- Syprina e punës me material antiacid, ky specifikim gjëndet në faqen 16, fjalia e parë e paragrafit të parë tek Cammon Features.

4- Suporti i jashtëm me strukture prej celiku te galvanizuar, ky specifikim gjëndet në faqen 16, fjalia e parë e paragrafit të parë tek Cammon Features.

5- Pajisur me lavaman me material celik inoks te integruar ne syprinën e punës, ky specifikim gjëndet në faqen 16, fjalia e parë e paragrafit të parë tek Cammon Features.

6- Pajisur me rubinet uji, ky specifikim gjëndet në faqen 16, fjalia e parë e paragrafit të katërt Control Panel.

7- Pajisur me te pakten 2 priza elektrike, ky specifikim gjëndet në faqen 16, fjalia e parë e paragrafit të katërt Control Panel.

8- Kabina duhet te kete ndricim, ky specifikim gjëndet në faqen 16, fjalia e parë e paragrafit të katërt Control Panel.

9-Pjesa ballore me xham sigurie te lëvizshëm, te laminuar te pakten 5mm, ky specifikim gjëndet në faqen 16, fjalia e parë e paragrafit të parë tek Cammon Features.

KPP pyet OE: Në cilën faqe të katalogut të ngarkuar në SPE nga ana juaj plotësohen specifikimet teknike për të cilat ngrihen pretendime nga operatori ekonomik ankimes për produktin me nr rendor 35 Furrë Mufel, konkretisht specifikimet:

1- Fuqia: maksimalisht 3kë

2- Koha e procesit: 1 minute - 99 ore 59 min

3- Termoelementi duhet te jete Ni – Cr Ni

4- Kontrolli i temperatures te mundesohet me PID Dixhital kontrolli

Përfaqësuesi i operatorit ekonomik z. N. C sqaron se: Specifikimi teknike për artikullin me nr rendor 35 Furrë Mufel, në katalogun e dorëzuar nga ana jonë në SPE me emërtesën Katalog Pajisje AKU P2 por dhe shpjegimet e paraqitura nga ana jonë sipas kërkesës tuaj evidentohen në këto faqe në katalog konkretisht:

1- Fuqia: maksimalisht 3kë, ky specifikim gjëndet në faqen 39 nga 3 Kë deri në 4.5 Kë, pra për sasinë e kërkuar nga AK 9 L të furrës pajisja jonë nuk e tejkalon konsumin e përcaktuar 3 Kë.

2- Koha e procesit: 1 minute - 99 ore 59 min, ky specifikim gjëndet në faqen 39 dhe nga 1 minute - 99 ore 59 min të kërkuara nga AK, pajisja jonë e ofron deri në 1-9999 min.

3- Termoelementi duhet te jete Ni – Cr Ni, ky specifikim gjëndet në faqen 39 të katalogut në paragrafin e trete fjalia e fundit, madje furra e ofruar nga ana jonë është e pajisur edhe me sensor platinum – rhodium sensor, sensor që ka temperaturë shumë herë më të lartë se një termocift bazik nikel-kromi.

4- Kontrolli i temperatures te mundesohet me PID Dixhital kontrolli, ky specifikim gjendet në faqen 39 të katalogut në paragrafin e trete fjalia e parë.

II.18. Në datën 15.02.2023, ora 12:30, në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik u mbajt seancë dëgjimore me përfaqësues të operatorit ekonomik “Krijon” SHPK dhe të autoritetit kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara, në prani të palëve të sipërcituara, në përgjigje të kërkesës së Komisionit të Prokurimit Publik, për sqarim për zërat (artikujt) me nr. rendor 20-22-35, në tabelën e specifikimeve teknike të dokumenteve standarde të tenderit, për të cilat operatori ekonomik ankimues është skualifikuar me pretendimin se këto zëra nuk plotësojnë specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

“Në prezencë të përfaqësuesve të autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik ankimues, KPP ndër të tjera, pyet:

KPP pyet OE: *Në cilën faqe të katalogut të ngarkuar në SPE nga ana juaj plotësohen specifikimet teknike për të cilat ngrihen pretendime nga operatori ekonomik ankimues për produktin me nr. rendor 20 HPLC With autosampler, DAD, konkretisht specifikimet:*

- 1- Pompa duhet te kete degazues te integruar me të paktën 4 kanale
- 2- Diapazoni i prurjes: të paktën 0.001- 10mL/min
- 3- Precizioni $\leq 0.07\%$ RSD
- 4- Saktësia e prurjes të paktën $\pm 1\%$
- 5- Moduli të punojë me presion më shumë se 580 bar
- 6- Formimi i gradientit të bëhet me anë të përzjerjes në presion të ulët
- 7- Kontrolli i çdo përbërësi të prurjes të ketë diapazon 0-100%
- 8- Pompë Kuaternare me dual piston ne seri
- 9- Saktësia e përberjes së prurjes $< 0.2\%$ RSD
- 10- Kompensimi i shtypjes te kete mundesi per tu zgjedhur nga perdoruesi Ph i rekomanduar 1-12.5
- 11- Kapaciteti i autosamplerit >200 vialë nga 2 ml
- 12- Diapazoni i volumit të injektimit: 0.1-100uL
- 13- Carry Over: më pak se 0.003%
- 14- Moduli të punojë me presion deri në 800bar
- 15- Koha e ciklit të injektimit $<10s$
- 16- Preçizioni i injektimit më pak se 0.15% RSD
- 17- Moduli të ketë kapacitet për 4 kolona nga 300 mm
- 18- Diapazoni i temperaturës: $10^{\circ}C$ nën ambient deri ne $85^{\circ}C$
- 19- Me 2 zona temperature
- 20- Saktësia e temperaturës: $\pm 0.5^{\circ}C$
- 21- Stabiliteti i temperatures: $\pm 0.1^{\circ}C$ ose me i mire
- 22- Koha e ngrohjes: < 6 min nga ambienti ne $40^{\circ}C$
- 23- Moduli të vijë i shoqëruar me një valvul 2 pozicione / 6porta
- 24- Dedektori duhet të ketë qelize matje 10 mm
- 25- Diapazoni i gjatesise se vales 190-640 nm ose me mire
- 26- Zhurma për qelize matje 10mm më e vogël se $\pm 3.2 \times 10^{-6}$

- 27- Dedektori duhet të ketë 1024-elemente diode me 8 sinjale.
- 28- Data rate të jetë te pakten 120Hz per spektra dhe sinjalet.
- 29- Drifti me pak se 0.5×10^{-3} AU/h
- 30- Dedektori duhet të ketë mundësi identifikimi automatik për qelizën e prurjes dhe për llampën (RFID) Lineariteti me shume se 2 AU në 265 nm
- 31- Softëare dhe aparatura e HPLC duhet të jetë nga i njëjti prodhues
- 32- Një PC dhe printer duhet të kontrollojë të gjithë modulet dhe të bëjë procesimin e të dhënave si, identifikimin e pikut, analizimin e të dhënave, kalibrimin, kuantifikimin dhe raportimin/ose ekuivalenti këtyre të dhënave.

Përfaqësuesi i operatorit ekonomik z. P. Z sqaron se: Specifikimi teknike për artikullin me nr rendor 20 HPLC Ëith autosampler, DAD, në katalogun e dorëzuar nga ana jonë në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific por dhe shpjegimet e paraqitura nga ana jonë sipas kërkesës tuaj evidentohen në këto faqe në katalog konkretisht:

- 1- Pompa duhet te kete degazues te integruar me të paktën 4 kanale, ky specifikim gjëndet në faqen 3 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific.
- 2- Diapazoni i prurjes: të paktën 0.001- 10mL/min, ky specifikim gjëndet në faqen 3 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific.
- 3- Precizioni ≤ 0.07 % RSD, ky specifikim gjëndet në faqen 3 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific.
- 4- Saktësia e prurjes të paktën $\pm 1\%$, ky specifikim gjëndet në faqen 3 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific. .
- 5- Moduli të punojë me presion më shumë se 580 bar, ky specifikim gjëndet në faqen 3 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific, nga 580 bar të kërkuar presioni i pajisjes tonë arrin deri në 700 bar.
- 6- Formimi i gradientit të bëhet me anë të përzjerjes në presion të ulët, ky specifikim gjëndet në faqen 3 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific.
- 7- Kontrolli i çdo përbërësi të prurjes të ketë diapazon 0-100%, ky specifikim gjëndet në faqen 8, paragrafi 2 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific.
- 8- Pompë Kuaternare me dual piston ne seri, ky specifikim gjëndet në faqen 3 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific.
- 9- Saktësia e përberjes së prurjes < 0.2 % RSD, ky specifikim gjëndet në faqen 3 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific. Ku nga < 0.2 % RSD, produkti ynë e ka < 0.15 % RSD.
- 10- Kompensimi i shtypjes te kete mundesi per tu zgjedhur nga perdoruesi Ph i rekomanduar 1-12.5, ky specifikim gjëndet në faqen 3 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific. Ku nga 1-12.5, produkti ynë e ka 1-13.
- 11- Kapaciteti i autosamplerit >200 viale nga 2 ml, ky specifikim gjëndet në faqen 10 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific.
- 12- Diapazoni i volumit të injektimit: 0.1-100uL, ky specifikim gjëndet në faqen 10 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific.
- 13- Carry Over: më pak se 0.003%, ky specifikim gjëndet në faqen 10 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific, ku nga 0.003 % të kërkuar nga AK, ne kemi ofertuar produktin me specifikim 0.002%.

- 14- Moduli të punojë me presion deri në 800 bar, ky specifikim gjëndet në faqen 10 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific, ku nga 800 bar të kërkuar nga AK, ne kemi ofertuar produktin me specifikim nga 20 bar deri në 1034 bar.
- 15- Koha e ciklit të injektimit <10s, ky specifikim gjëndet në faqen 10 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific, ku nga <10s, të kërkuar nga AK, ne kemi ofertuar produktin me specifikim 8 s.
- 16- Preçizioni i injektimit më pak se 0.15% RSD, ky specifikim gjëndet në faqen 10 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific, ku nga 0.15% RSD, të kërkuar nga AK, ne kemi ofertuar produktin me specifikim <0.25% area RSD.
- 17- Moduli të ketë kapacitet për 4 kolona nga 300 mm, ky specifikim gjëndet në faqen 13 dhe 14 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific.
- 18- Diapazoni i temperaturës: 10°C nën ambient deri ne 85°C, ky specifikim gjëndet në faqen 14 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific, ku nga 10 grade C – 85 grade C, të kërkuar nga AK, ne kemi ofertuar produktin me specifikim 5 grade C – 85 grade C.
- 19- Me 2 zona temperature, ky specifikim gjëndet në faqen 14 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific, ku nga 2 zona të kërkuar nga AK, ne kemi ofertuar produktin me specifikim me 3 zona temperature.
- 20- Saktësia e temperaturës: $\pm 0.5^{\circ}\text{C}$, ky specifikim gjëndet në faqen 14 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific.
- 21- Stabiliteti i temperatures: $\pm 0.1^{\circ}\text{C}$ ose me i mire, ky specifikim gjëndet në faqen 14 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific, ku nga $\pm 0.1^{\circ}\text{C}$ të kërkuar nga AK, ne kemi ofertuar produktin me specifikim $\pm 0.05^{\circ}\text{C}$.
- 22- Koha e ngrohjes: < 6 min nga ambienti ne 40°C, ky specifikim gjëndet në faqen 14 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific, ku nga < 6 min nga ambienti ne 40°C të kërkuar nga AK, ne kemi ofertuar produktin me specifikim nga 25°C - 40°C për 5 min.
- 23- Moduli të vijë i shoqëruar me një valvul 2 pozicione / 6 porta, ky specifikim gjëndet në faqen 14 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific.
- 24- Dedektori duhet të ketë qelize matje 10 mm, ky specifikim gjëndet në faqen 19 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific
- 25- Diapazoni i gjatesise se vales 190-640 nm ose me mire, ky specifikim gjëndet në faqen 17 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific, ku nga 190-640 nm të kërkuar nga AK, ne kemi ofertuar produktin me specifikim nga 190-680 nm.
- 26- Zhurma për qelize matje 10mm më e vogël se $\pm 3.2 \times 10^{-6}$, ky specifikim gjëndet në faqen 17 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific, ku nga $\pm 3.2 \times 10^{-6}$ të kërkuar nga AK, ne kemi ofertuar produktin me specifikim $< \pm 3 \text{ AU}$ në 230 nm..
- 27- Dedektori duhet të ketë 1024-elemente diode me 8 sinjale, ky specifikim gjëndet në faqen 17, të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific.
- 28- Data rate të jetë te pakten 120Hz per spektra dhe sinjalet, ky specifikim gjëndet në faqen 17 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific, ku nga 120 Hz të kërkuar nga AK, ne kemi ofertuar produktin me specifikim deri në 200 Hz.

29- Drifti me pak se 0.5×10^{-3} AU/h, ky specifikim gjëndet në faqen 17 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific, ku nga 0.5×10^{-3} AU/h të kërkuar nga AK, ne kemi ofertuar produktin me specifikim <0.5 mAU/h në 230 nm.

30- Dedektori duhet të ketë mundësi identifikimi automatik për qelizën e prurjes dhe për llampën (RFID) Lineariteti me shumë se 2 AU në 265 nm, ky specifikim gjëndet në faqen 17 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific, ku nga 2 AU në 265 nm të kërkuar nga AK, ne kemi ofertuar produktin me specifikim $<5\%$ në 2.0 AU.

31- Softëare dhe aparatura e HPLC duhet të jetë nga i njëjti prodhues, ky specifikim gjëndet në faqen 17, të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific.

32- Një PC dhe printer duhet të kontrollojë të gjithë modulet dhe të bëjë procesimin e të dhënave si, identifikimin e pikut, analizimin e të dhënave, kalibrimin, kuantifikimin dhe raportimin/ose ekuivalenti këtyre të dhënave, ky specifikim gjëndet në faqen 17, të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific.

KPP pyet OE: Në cilën faqe të katalogut të ngarkuar në SPE nga ana juaj plotësohen specifikimet teknike për të cilat ngrihen pretendime nga operatori ekonomik ankimes për produktin me nr rendor 22 Kape Kimike, konkretisht specifikimet:

1- Gjerësia 1100 mm - 1200 mm,

2- Kapaciteti thithës mbi 1700 m³/ore

3- Syprina e punës me material antiacid

4- Suporti i jashtëm me strukture prej celiku të galvanizuar

5- Pajisur me lavaman me material celik inoks të integruar në syprinën e punës

6- Pajisur me rubinet uji

7- Pajisur me të pakten 2 priza elektrike

8- Kabina duhet të ketë ndricim

9- Pjesa ballore me xham sigurie të lëvizshëm, të laminuar të pakten 5mm

Përfaqësuesi i operatorit ekonomik z. P. Z sqaron se: Specifikimi teknike për artikullin me nr rendor 22 Kapë Kimike, në katalogun e dorëzuar nga ana jonë në SPE me emërtesën 22 Equiplabo por dhe shpjegimet e paraqitura nga ana jonë sipas kërkesës tuaj evidentohen në këto faqe në katalog konkretisht:

1- Gjerësia 1100 mm - 1200 mm, ky specifikim gjëndet në faqen 8, të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 22 Equiplabo.

2- Kapaciteti thithës mbi 1700 m³/ore, ky specifikim gjëndet në faqen 13, të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 22 Equiplabo.

3- Syprina e punës me material antiacid, ky specifikim gjëndet në faqen 1 dhe 19 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 22 Equiplabo.

4- Suporti i jashtëm me strukture prej celiku të galvanizuar, ky specifikim gjëndet në faqen 1, 9 dhe 19 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 22 Equiplabo.

5- Pajisur me lavaman me material celik inoks të integruar në syprinën e punës, ky specifikim gjëndet në faqen 1, 9 dhe 19, të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 22 Equiplabo.

6- Pajisur me rubinet uji, ky specifikim gjëndet në faqen 15 dhe 16, të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 22 Equiplabo.

7- Pajisur me të pakten 2 priza elektrike, ky specifikim gjëndet në faqen 17, të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 22 Equiplabo.

8- Kabina duhet te kete ndricim, ky specifikim gjendet në faqen 3 dhe 4, të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 22 Equiplabo.

9-Pjesa ballore me xham sigurie te lëvizshëm, te laminuar te pakten 5mm, ky specifikim gjendet në faqen 1, të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 22 Equiplabo.

KPP pyet OE: Në cilën faqe të katalogut të ngarkuar në SPE nga ana juaj plotësohen specifikimet teknike për të cilat ngrihen pretendime nga operatori ekonomik ankimes për produktin me nr rendor 35 Furrë Mufel, konkretisht specifikimet:

1- Fuqia: maksimalisht 3kë

2- Koha e procesit: 1 minute - 99 ore 59 min

3- Termoelementi duhet te jete Ni – Cr Ni

4- Kontrolli i temperatures te mundesohet me PID Dixhital kontrolli

Përfaqësuesi i operatorit ekonomik z. P. Z sqaron se: Specifikimi teknike për artikullin me nr rendor 35 Furrë Mufel, në katalogun e dorëzuar nga ana jonë në SPE me emërtesën 35 Snol por dhe shpjegimet e paraqitura nga ana jonë sipas kërkesës tuaj evidentohen në këto faqe në katalog konkretisht:

1- Fuqia: maksimalisht 3kë, ky specifikim gjendet në faqen 3, të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 35 Snol.

2- Koha e procesit: 1 minute - 99 ore 59 min, ky specifikim gjendet në faqen 11, të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 35 Snol.

3- Termoelementi duhet te jete Ni – Cr Ni, ky specifikim gjendet në faqen 5, të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 35 Snol.

4- Kontrolli i temperatures te mundesohet me PID Dixhital kontrolli, ky specifikim gjendet në faqen 8, të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 35 Snol.

II.19. Komisioni Prokurimit Publik më datë 15.03.2023 në seancën dëgjimore të mbajtur në orën 12:00 me operatorin ekonomik “Isometric” SHPK dhe në orën 12:30 me operatorin ekonomik “Krijon” SHPK, në prani dhe të përfaqësuesve të autoritetit kontraktor, ju la detyrë si operatorëve ekonomikë ashtu dhe përfaqësuesve të autoritetit kontraktor, që brenda datës 20.03.2023, të sillnin pranë Komisionit Prokurimit Publik cdo sqarim, argument apo interpretim shtesë në lidhje me mënyrën e plotësimit të disa prej specifikimeve teknike.

II.20. Më datë 20.02.2023 protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik, me shkresën 121/19 prot, datë 20.03.2023, operatori ekonomik “Isometric” SHPK ka dërguar sqarimet në lidhje me pyetjet e ngritura gjatë seancës dëgjimore të datës 15.03.2023 ora 12:00.

II.21. Më shkresën nr. 80 prot, datë 20.02.2023, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me shkresën 589 prot, datë 20.03.2023, operatori ekonomik “Krijon” SHPK ka dërguar sqarimet në lidhje me pyetjet e ngritura gjatë seancës dëgjimore të datës 15.03.2023 ora 12:30.

II.22. Me shkresën nr. 413/5 prot., datën 20.03.2023, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me shkresën nr. 589/1 prot, datë 23.03.2023 është depozituar kërkesë nga autoritetit kontraktor, nëpërmjet së cilës kërkon që t'i vihen në dispozicion procesverbalet e seancave dëgjimore.

II.23. Më shkresën nr. 512 prot, datë 04.04.2023 protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me shkresën 589/3 prot, datë 06.04.2023, autoriteti kontraktor ka dorëzuar shkresën me objekt “Mbi pretendimet e ankimit administrativ nga subjekti “Almedical” SHPK në lidhje me pyetjet e ngritura gjatë seancës dëgjimore të datës 15.03.2023.

II.24. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se pranë Komisionit të Prokurimit Publik është depozituar formulari i paraqitjes së argumenteve nga operatorët ekonomikë të interesuar “Krijon” SHPK, me shkresën nr. 121/5 prot, datë 30.01.2023 dhe nga operatori ekonomik “Isometric” SHPK me shkresën nr. 121/6 prot, datë 31.01.2023 sipas parashikimeve në nenin 113 ligji Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Almedical” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Medfau” SHPK me arsyet: “Ky operator ekonomik nuk përmbush specifikimet teknike për artikujt me nr 20, 22 dhe 35 konkretisht **Për artikullin me nr 20 HPLC With autosampler, DAD** nuk plotëson specifikimet teknike si **1-** Pompa duhet te kete degazues te integruar me të paktën 4 kanale Diapazoni i prurjes: të paktën 0.001- 10mL/min ; **2-** Precizioni $\leq 0.07\%$ RSD; **3-** Saktësia e prurjes të paktën $\pm 1\%$; **4-** Moduli të punojë me presion më shumë se 580 bar; **5-** Formimi i gradientit të bëhet me anë të përzjerjes në presion të ulët Kontrolli i çdo përbërësi të prurjes të ketë diapazon 0-100%; **6-** Pompë Kuarternare me dual piston ne seri; **7-** Saktësia e përberjes së prurjes $< 0.2\%$ RSD; **8-** Kompensimi i shtypjes te kete mundesi per tu zgjedhur nga perdoruesi Ph i rekomanduar 1-12.5; **9-** Kapaciteti i autosamplerit > 200 viale nga 2 ml; **10-** Diapazoni i volumit të injektimit: 0.1-100 uL; **11-** Carry Over: më pak se 0.003%; **12-** Moduli të punojë me presion deri në 800 bar; **13-** Koha e ciklit të injektimit < 10 s; **14-** Precizioni i injektimit më pak se 0.15% RSD; **15-** Moduli të ketë kapacitet për 3 kolona nga 300mm; **16-** Diapazoni i temperaturës: 10°C nën ambient deri ne 85°C ; **17-** Me 2 zona temperature; **18-** Saktësia e temperaturës: $\pm 0.5^{\circ}\text{C}$; **19-** Stabiliteti i temperatures: $\pm 0.1^{\circ}\text{C}$ ose me 1 mire; **20-** Koha e ngrohjes: < 6 min nga ambienti ne 40°C ; **21-** Moduli të vijë i shoqëruar me një valvul 2 pozicione / 6porta; **22-** Dedektori duhet të ketë qelize matje 10mm; **23-** Diapazoni i gjatesise se vales 190-640 nm ose me mire; **24-** Zhurma për qelize matje 10mm më e vogël se $\pm 3.2 \times 10^{-6}$; **25-** Dedektori duhet të ketë 1024-elemente diode me 8 sinjale; **26-** Data rate të jetë te pakten 120 Hz per spektra dhe sinjalet; **27-** Drifti me pak se 0.5×10^{-3} AU/h; **28-** Dedektori duhet të ketë mundesi identifikimi automatik për qelizen e prurjes dhe per llampen (RFID) Lineariteti me shume se 2 AU ne 265nm; **29-** Softëare dhe aparatura e HPLC duhet të jetë nga i njëjti prodhues; **30-** Një PC dhe printer duhet të kontrollojë të gjithë modulet dhe të bëjë procesimin e të dhënave

si, identifikimin e pikut, analizimin e të dhënave, kalibrimin, kuantifikimin dhe raportimin/ose ekuivalenti këtyre të dhënave; **Për artikullin me nr 22. Kape kimike** nuk plotëson specifikimet teknike si **1-** Gjerësia 1100 mm - 1200 mm; **2-** Kapaciteti thithës mbi 1700 m³/ore; **3-** Syprina e punës me material antiacid; **4-** Suporti i jashtëm me strukture prej celiku te galvanizuar; **5-** Pajisur me lavaman me material celik inoks te integruar ne syprinën e punës; **6-** Pajisur me rubinet uji; **7-** Pajisur me te pakten 2 priza elektrike; **8-** Kabina duhet te kete ndricim; **9-** Pjesa ballore me xham sigurie te lëvizshëm, te laminuar te pakten 5mm; **Ndërsa për artikullin me nr. 35. Furre Mufel** nuk plotëson specifikimet teknike si **1-** Fuqia: maksimalisht 3kë; **2-** Koha e procesit: 1 minute - 99 ore 59 min; **3-** Termoelementi duhet te jete Ni – Cr Ni; **4-** Kontrolli i temperatures te mundesohet me PID Dixhital kontrolli”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.1.4 “Kapaciteti Teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.1.4. Operatori ekonomik të paraqesë **katalog teknik të mallit**, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar. Në katalogë duhet të markohen (për lehtësi identifikimi) specifikimet teknike, të përcaktuara në Shtojcën 5 të DT.

III.1.2. Në shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve Teknike” të modifikuar në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

ISHTE

20. HPLC With autosampler, DAD (1 copë)

Sistem HPLC Modular i perbere nga:

POMPA

Pompa duhet te kete degazues te integruar me të paktën 4 kanale Diapazoni i prurjes: të paktën 0.001- 10mL/min

Precizionin ≤ 0.07 % RSD

Saktësia e prurjes të paktën ± 1 %

Moduli të punojë me presion më shumë se 580 bar

Formimi i gradientit të bëhet me anë të përzjerjes në presion të ulët Kontrolli i çdo përbërësi të prurjes të ketë diapazon 0-100%

Pompë Kuaternare me dual piston ne seri

Saktësia e përberjes së prurjes < 0.2 % RSD

Kompensimi i shtypjes te kete mundesi per tu zgjedhur nga perdoruesi Ph i rekomanduar 1-12.5

AUTOSAMPLER

Kapaciteti i autosamplerit >200 vialë nga 2 ml

Diapazoni i volumit të injektimit: 0.1-100uL

Carry Over: më pak se 0.003%

Moduli të punojë me presion deri në 800bar

Koha e ciklit të injektimit <10 s

Preçizioni i injektimit më pak se 0.15% RSD

TERMOSTATI I KOLONAVE

Moduli të ketë kapacitet për 3 kolona nga 300mm

Diapazoni i temperaturës: 10°C nën ambient deri në 85°C

Me 2 zona temperature

Saktësia e temperaturës: $\pm 0.5^\circ\text{C}$

Stabiliteti i temperatures: $\pm 0.1^\circ\text{C}$ ose më mirë

Koha e ngrohjes: < 6 min nga ambienti në 40°C

Moduli të vijë i shoqëruar me një valvul 2 pozicione / 6porta

DAD

Dedektori duhet të ketë qelize matje 10mm

Diapazoni i gjatësisë së vales 190-640 nm ose më mirë

Zhurma për qelize matje 10mm më e vogël se $\pm 3.2 \times 10^{-6}$

Dedektori duhet të ketë 1024-elemente diode me 8 sinjale.

Data rate të jetë të pakten 120Hz për spektra dhe sinjalet.

Drifti më pak se 0.5×10^{-3} AU/h

Dedektori duhet të ketë mundësi identifikimi automatik për qelizen e prurjes dhe për llamben

(RFID) Lineariteti më shumë se 2 AU në 265nm

SOFTËARE

Softëare dhe aparatura e HPLC duhet të jetë nga i njëjti prodhues

Një PC dhe printer duhet të kontrollojë të gjithë modulet dhe të bëjë procesimin e të dhënave si, identifikimin e pikut, analizimin e të dhënave, kalibrimin, kuantifikimin dhe raportimin/ose ekuivalenti këtyre të dhënave

22. Kape kimike (1 copë)

Gjerësia 1100 mm - 1200 mm

Kapaciteti thithës mbi 1700 m³/ore

Syprina e punës me material antiacid

Suporti i jashtëm me strukture prej çeliku të galvanizuar

Pajisur me lavaman me material çelik inoks të integruar në syprinën e punës

Pajisur me rubinet uji

Pajisur me të pakten 2 priza elektrike

Kabina duhet të ketë ndricim

Pjesa ballore me xham sigurie të lëvizshëm, të laminuar të pakten 5mm

35. Furre Mufel (1 copë)

Furre mufel për përdorim laboratorik.

Materjali izolues duhet të jetë lesh qeramike

Temperatura jo më e vogël se 550 °C

Vëllimi i furrës: jo më pak se 9L

Fuqia: maksimalisht 3kË

Koha e procesit: 1 minute - 99 ore 59 min

Termoelementi duhet te jete Ni – Cr Ni
Mundësi programimi me hapa 1°C
Kontrolli i temperatures te mundesohet me PID Dixhital kontrolli
Struktura e dhomes duhet te jete rezistente nga temperaturat e larta

BËHET

20. HPLC Ëith autosampler, DAD (1 copë)

Sistem HPLC Modular i perbere nga:

POMPA

Pompa duhet te kete degazues me të paktën 3-4 kanale Diapazoni i prurjes: të paktën 0.001-10mL/min

Precizioni ≤ 0.07 % RSD

Saktësia e prurjes të paktën ± 1 %

Moduli të punojë me presion më shumë se 580 bar

Formimi i gradientit të bëhet me anë të përzjerjes në presion të ulët Kontrolli i çdo përbërësi të prurjes të ketë diapazon 0-100%

Pompë Kuaternare me dual piston ne seri

Saktësia e përberjes së prurjes < 0.2 % RSD Ky parameter ka te beje me precizionin e perberjes se prurjes dhe eshte nje nder parametrat e rendesishem te analizimit me pajisjen HPLC. Precizioni i perberjes eshte nje parameter qe plotesohet nga te gjithë prodhuesit

Kompensimi i shtypjes te kete mundesi per tu zgjedhur nga perdoruesi Ph i rekomanduar 1-12.5

AUTOSAMPLER

Kapaciteti i autosamplerit >200 viale nga 2 ml Zvogelimi i kapacitetit te autosamplerit ul rendimentin e laboratorit ne analize dhe rrit koston e laboratorit

Diapazoni i volumit të injektimit: 0.1-100uL

Carry Over: më pak se 0.003%

Moduli të punojë me presion deri në 800bar

Koha e ciklit të injektimit <10 s

Precizionin i injektimit më pak se 0.15% RSD

TERMOSTATI I KOLONAVE

Moduli te kete kapacitet per te pakten 3 kolona prej 300mm.

Diapazoni i temperaturës: 10°C nën ambient deri ne 85°C

Me 2 zona temperature

Saktësia e temperaturës: ± 0.5 °C

Stabiliteti i temperatures: ± 0.1 °C ose me I ulet

Koha e ngrohjes: < 6 min nga ambienti ne 40°C Shpejtesia e ngrohjes se kolones ndikon ne kohen e analizave duke zvogeluar numrin total te tyre dhe ne kete menyre duke ulur rendimentin

Moduli të vijë i shoqëruar me një valvul 2 pozicione / 6porta

DAD

Dedektori duhet të ketë qelize matje 10mm

Diapazoni i gjatesise se vales 190-640 nm ose me gjere
Zhurma për qelize matje 10mm më e vogël se $\pm 3.2 \times 10^{-6}$
Dedektori duhet të ketë 1024-elemente diode me 8 sinjale.
Data rate të jetë te pakten 120Hz per spektra dhe sinjalet. Shpejtesia e marrjes se te dhenave eshte e rendesishme ne performancen e pikut. Vlera me me larta se 120Hz jane te mirepritura.
Drifti me pak se 0.5×10^{-3} AU/h
Dedektori duhet të ketë mundesi identifikimi automatik për qelizen e prurjes dhe per llampen (RFID) Lineariteti me shume se 2 AU ne 265nm

SOFTËARE

Softëare dhe aparatura e HPLC duhet të jetë nga i njëjti prodhues
Një PC dhe printer duhet të kontrollojë të gjithë modulet dhe të bëjë procesimin e të dhënave si, identifikimin e pikut, analizimin e të dhënave, kalibrimin, kuantifikimin dhe raportimin/ose ekuivalenti këtyre të dhënave

22. Kape kimike (1 copë)

Gjerësia 1100 mm - 1200 mm
Kapaciteti thithës mbi 1700 m³/ore
Syprina e punës me material antiacid
Suporti i jashtem me strukture prej celiku te galvanizuar
Pajisur me lavaman me material celik inoks te integruar ne syprinën e punës
Pajisur me rubinet uji
Pajisur me te pakten 2 priza elektrike
Kabina duhet te kete ndricim
Pjesa ballore me xham sigurie te lëvizshëm, te laminuar te pakten 5mm

35. Furre Mufel (1 copë)

Furre mufel për përdorim laboratorik.
Materjali izolues duhet te jete lesh qeramike
Temperatura jo më e vogël se 550 °C
Vëllimi i furrës: jo me pak se 9L
Fuqia: maksimalisht 3kË
Koha e procesit: 1 minute - 99 ore 59 min
Termoelementi duhet te jete Ni – Cr Ni
Mundësi programimi me hapa 1°C
Kontrolli i temperatures te mundesohet me PID Dixhital kontrolli
Struktura e dhomes duhet te jete rezistente nga temperaturat e larta
III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “*Medfau*” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Kat pjesa 1 Art 22. 23. 13. 36. pdf
- Kat pjesa 2 Art 19. 20. pdf
- Kat pjesa 3 Art 14. 15. 18. 37. 38 pdf

- Kat pjesa 4 Art 8. 34. 35. 12. 24. 39. 29. 9. 32 pdf
- Kat pjesa 5 Art 16. 5. 6. 2. 30. 25. 7. 1 pdf
- Kat pjesa 6 Art 4. 40. 31. 33. 17. pdf
- Kat pjesa 7 Art 3. 21. 11. 10 pdf
- Nueve Katalog pos 27 pdf

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.5. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.6. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

“1.Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor."

III.1.7. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.8. Në nenin Neni 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.1.9. Në nenin 40, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.1.10. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.11. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, KPP vëren se, autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, në shtojcën 5 “*Formulari i specifikimeve teknike*”, ka përcaktuar specifikimet teknike të cilat duhet të përmbushin produktet objekt prokurimi. Gjithashtu, në “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, pika 2.1.4 e “*Kapacitetit teknik*”, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë. (Katalogët duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT (Dokumentat duhet të jenë të perkthyer dhe të noterizuara). KPP konstaton, se qëllimi i këtij kriteri është që nëpërmjet katalogëve të kërkuar, të verifikohen specifikimet teknike të produkteve të ofruara nga operatorët

ekonomikë, për të parë përputhshmërinë e tyre me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për këto artikuj.

III.1.12. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “*Medfau*” SHPK, konstaton, se ky i fundit, për të plotësuar kriterin e mësipërm ka paraqitur katalogët e produkteve të ofertuara. Konkretisht Kat pjesa 1 Art 22. 23. 13. 36. Pdf (i përkthyer dhe i noterizuar); Kat pjesa 2 Art 19. 20. Pdf (i përkthyer dhe i noterizuar); Kat pjesa 4 Art 8. 34. 35. 12. 24. 39. 29. 9. 32 pdf (i përkthyer dhe i noterizuar); si dhe katalogët e produkteve të tjera të ofruara, të përkthyer dhe të noterizuar.

Në kuadër të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke qenë se KPP shfaq vështirësi në evidentimin dhe verifikimin e specifikimeve teknike për të cilat operatori ekonomik ankimues “*Almedical*” SHPK pretendon, se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “*Medfau*” SHPK, për disa nga artikujt, tek katalogët dhe dokumentacioni i paraqitur nga ky i fundit në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), KPP me anë të shkresës nr. 121/8 prot., datë 02.03.2023, i kërkoi operatorit ekonomik “*Medfau*” SHPK, me qëllim gjykimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, të dorëzojë pranë KPP-së informacionin dhe faktet se në cilin katalog apo dokument (faqe, paragraf etj.), nga ato të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, gjenden artikujt me specifikimet teknike të lartpërmendura nga operatori ekonomik ankimues.

Me datë 06.03.2023, protokolluar me tonën me shkresën nr. 121/12 prot, datë 06.03.2023 me objekt: “*Kthim-përgjigje*” operatori ekonomik “*Medfau*” SHPK ka dërguar informacion pranë Komisionit Prokurimit Publik, në lidhje me objektin e kërkesës nr. 121/8 prot, datë 02.03.2023. Gjithashtu, KPP me shkresën nr. 121/16 prot, datë 13.03.2023 njoftoi operatorin ekonomik “*Medfau*” SHPK dhe autoritetin kontraktor, për zhvillimin e një seance dëgjimore më datë 15.03.2023, ora 11:30, për të bërë të mundur evientimin dhe verifikimin e specifikimeve teknike në katalog, me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit. Në ditën dhe orën e përcaktuar në shkresën e sipërcituar, nuk u paraqit pranë KPP-së asnjë përfaqësues i operatorit ekonomik “*Medfau*” SHPK, gjithashtu nuk rezultoi të jetë dorëzuar kërkesë për shtyerje seance po nga ky operator ekonomik.

III.1.13. Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, dokumentacioni i dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “*Medfau*” SHPK, si dhe sqarimet e vetë këtij të fundit dorëzuar pranë KPP-së, vërejmë se disa nga specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit nuk gjenden të pasqyruara në katalogët e dorëzuar nga operatori ekonomik “*Medfau*” SHPK në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe disa të tjera nuk janë në përputhje me specifikimet e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentet standarde të tenderit.

Konkretisht, për artikullin nr. 22 Kape Kimike në specifikimet teknike autoriteti kontraktor ka përcaktuar 1- *Gjerësia 1100 mm - 1200 mm*; 2- *Kapaciteti thithës mbi 1700 m3/ore*; 3- *Syprina e punës me material antiacid*; 4- *Suporti i jashtëm me strukture prej celiku te galvanizuar*; 5- *Pajisur me lavaman me material celik inoks te integruar ne syprinën e punës*; 6- *Pajisur me rubinet uji*; 7- *Pajisur me te pakten 2 priza elektrike*; 8- *Kabina duhet te kete ndricim*; 9- *Pjesa ballore me xham sigurie te lëvizshëm, te laminuar te pakten 5mm*”,

ndërkohë nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Medfau” SHPK, si dhe informacioni i dorëzuar nga ky i fundit pranë KPP-së, konstatohet se, në faqen 34-41 të katalogut “*Kat pjesa 1 Art 22. 23. 13. 36. Pdf*” për pajisjen “*Kapë Kimike*”, përcaktohet gjërsia 900 mm ndërsa nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike është kërkuar gjërsia të jetë nga 1100-1200 mm, kapaciteti thithës mbi 1700m³/orë nuk përcaktohet fare në katalog për këtë pajisje, gjithashtu diametri i xhamit është kërkuar 5 mm, nga verifikimi i katalogut të dorëzuar nga faqja 34-41, nuk rezulton të jetë i përcaktuar ky specifikim në katalog, pra nga verifikimi në tërësi i katalogut të dorëzuar nga operatori ekonomik “Medfau” SHPK në SPE, por dhe sqarimeve të paraqitura pranë KPP-së konstatohet, se në këtë katalog nuk pasqyrohen të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues.

Në lidhje me artikullin nr. 35 Furre Mufel në specifikimet teknike autoriteti kontraktor ka përcaktuar “*1- Furre mufel për përdorim laboratorik; 2- Materjali izolues duhet te jete lesh qeramike; 3- Temperatura jo më e vogël se 550 °C; 4- Vëllimi i furrës: jo me pak se 9L; 5- Fuqia: maksimalisht 3kë; 6- Koha e procesit: 1 minute - 99 ore 59 min; 7- Termoelementi duhet te jete Ni – Cr Ni; 8- Mundësi programimi me hapa 1°C; 9- Kontrolli i temperatures te mundesohet me PID Dixhital kontrolli; 10- Struktura e dhomes duhet te jete rezistente nga temperaturat e larta*”, ndërkohë nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Medfau” SHPK, si dhe informacioni i dorëzuar nga ky i fundit pranë KPP-së, konstatohet se, në faqen 16-19 të katalogut “*Kat pjesa 4 Art 8. 34. 35. 12. 24. 39. 29. 9. 32 pdf*” për pajisjen “*Furre Mufel*”, përcaktohet koha e procesit: 1 minute - 99 ore 59 min, Termoelementi duhet të jetë Ni – Cr Ni, nga verifikimi i katalogut të sipërcituar nuk rezultojnë të përcaktuara këto dy specifikime teknike në katalog për këtë pajisje, pra nga verifikimi i katalogut të dorëzuar nga operatori ekonomik “Medfau” SHPK konstatohet, se në këtë katalog nuk pasqyrohen të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues.

Sa më sipër argumentuar, konstatojmë, se disa nga specifikimet teknike të artikujve të mësipërm, nuk gjejnë pasqyrim në katalogët e dorëzuar nga operatori ekonomik “Medfau” SHPK, duke mos plotësuar kështu kërkesat e autoritetit kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik duhet të dorëzojë të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Sqarojmë se, bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, i ndryshuar, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë.

Rrjedhimisht, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Medfau” SHPK qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Almedical” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Isometric” SHPK me arsyet: “Ky operator ekonomik nuk përmbush specifikimet teknike për artikujt me nr 20, 22 dhe 35 konkretisht **Për artikullin me nr 20 HPLC With autosampler, DAD** nuk plotëson specifikimet teknike si **1-** Pompa duhet të ketë degazues të integruar me të paktën 4 kanale Diapazoni i prurjes: të paktën 0.001- 10mL/min ; **2-** Precizioni $\leq 0.07\%$ RSD; **3-** Saktësia e prurjes të paktën $\pm 1\%$; **4-** Moduli të punojë me presion më shumë se 580 bar; **5-** Formimi i gradientit të bëhet me anë të përzjerjes në presion të ulët Kontrolli i çdo përbërësi të prurjes të ketë diapazon 0-100%; **6-** Pompë Kuaternare me dual piston ne seri; **7-** Saktësia e përberjes së prurjes $< 0.2\%$ RSD; **8-** Kompensimi i shtypjes te kete mundesi per tu zgjedhur nga perdoruesi Ph i rekomanduar 1-12.5; **9-** Kapaciteti i autosamplers > 200 vialë nga 2 ml; **10-** Diapazoni i volumit të injektimit: 0.1-100 uL; **11-** Carry Over: më pak se 0.003%; **12-** Moduli të punojë me presion deri në 800 bar; **13-** Koha e ciklit të injektimit < 10 s; **14-** Precizioni i injektimit më pak se 0.15% RSD; **15-** Moduli të ketë kapacitet për 3 kolona nga 300mm; **16-** Diapazoni i temperaturës: 10°C nën ambient deri ne 85°C; **17-** Me 2 zona temperature; **18-** Saktësia e temperaturës: $\pm 0.5^\circ\text{C}$; **19-** Stabiliteti i temperatures: $\pm 0.1^\circ\text{C}$ ose me 1 mire; **20-** Koha e ngrohjes: < 6 min nga ambienti ne 40°C; **21-** Moduli të vijë i shoqëruar me një valvul 2 pozicione / 6porta; **22-** Dedektori duhet të ketë qelize matje 10mm; **23-** Diapazoni i gjatesise se vales 190-640 nm ose me mire; **24-** Zhurma për qelize matje 10mm më e vogël se $\pm 3.2 \times 10^{-6}$; **25-** Dedektori duhet të ketë 1024-elemente diode me 8 sinjale; **26-** Data rate të jetë te pakten 120 Hz per spektra dhe sinjalet; **27-** Drifti me pak se 0.5×10^{-3} AU/h; **28-** Dedektori duhet të ketë mundesi identifikimi automatik për qelizen e prurjes dhe per llampen (RFID) Lineariteti me shume se 2 AU ne 265nm; **29-** Softëare dhe aparatura e HPLC duhet të jetë nga i njëjti prodhues; **30-** Një PC dhe printer duhet të kontrollojë të gjithë modulet dhe të bëjë procesimin e të dhënave si, identifikimin e pikut, analizimin e të dhënave, kalibrimin, kuantifikimin dhe raportimin/ose ekuivalenti këtyre të dhënave; **Për artikullin me nr 22. Kape kimike** nuk plotëson specifikimet teknike si **1-** Gjerësia 1100 mm - 1200 mm; **2-** Kapaciteti thithës mbi 1700 m³/ore; **3-** Syprina e punës me material antiacid; **4-** Suporti i jashtëm me strukture prej celiku te galvanizuar; **5-** Pajisur me lavaman me material celik inoks te integruar ne syprinën e punës; **6-** Pajisur me rubinet uji; **7-** Pajisur me te pakten 2 priza elektrike; **8-** Kabina duhet te kete ndricim; **9-** Pjesa ballore me xham sigurie te lëvizshëm, te laminuar te pakten 5mm; **Ndërsa për artikullin me nr. 35. Furre Mufel** nuk plotëson specifikimet teknike si **1-** Fuqia: maksimalisht 3kë; **2-** Koha e procesit: 1 minute - 99 ore 59 min; **3-** Termoelementi duhet te jete Ni – Cr Ni; **4-** Kontrolli i temperatures te mundesohet me PID Dixhital kontrolli”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.1.4 “Kapaciteti Teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.1.4. Operatori ekonomik të paraqesë **katalog teknik të mallit**, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar. Në katalogë duhet të markohen (për lehtësi identifikimi) specifikimet teknike, të përcaktuara në Shtojcën 5 të DT.

III.2.2. Në shtojcën 5 “*Formulari i Specifikimeve Teknike*” të modifikuar në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

ISHTE

20. HPLC Ëith autosampler, DAD (1 copë)

Sistem HPLC Modular i perbere nga:

POMPA

Pompa duhet te kete degazues te integruar me të paktën 4 kanale Diapazoni i prurjes: të paktën 0.001- 10mL/min

Precizioni $\leq 0.07\%$ RSD

Saktësia e prurjes të paktën $\pm 1\%$

Moduli të punojë me presion më shumë se 580 bar

Formimi i gradientit të bëhet me anë të përzjerjes në presion të ulët Kontrolli i çdo përbërësi të prurjes të ketë diapazon 0-100%

Pompë Kuaternare me dual piston ne seri

Saktësia e përberjes së prurjes $< 0.2\%$ RSD

Kompensimi i shtypjes te kete mundesi per tu zgjedhur nga perdoruesi Ph i rekomanduar 1-12.5

AUTOSAMPLER

Kapaciteti i autosamplerit >200 vialë nga 2 ml

Diapazoni i volumit të injektimit: 0.1-100uL

Carry Over: më pak se 0.003%

Moduli të punojë me presion deri në 800bar

Koha e ciklit të injektimit <10 s

Precizionin i injektimit më pak se 0.15% RSD

TERMOSTATI I KOLONAVE

Moduli të ketë kapacitet për 3 kolona nga 300mm

Diapazoni i temperaturës: 10°C nën ambient deri ne 85°C

Me 2 zona temperature

Saktësia e temperaturës: $\pm 0.5^\circ\text{C}$

Stabiliteti i temperatures: $\pm 0.1^\circ\text{C}$ ose me I mire

Koha e ngrohjes: < 6 min nga ambienti ne 40°C

Moduli të vijë i shoqëruar me një valvul 2 pozicione / 6porta

DAD

Dedektori duhet të ketë qelize matje 10mm

Diapazoni i gjatesise se vales 190-640 nm ose me mire

Zhurma për qelize matje 10mm më e vogël se $\pm 3.2 \times 10^{-6}$

Dedektori duhet të ketë 1024-elemente diode me 8 sinjale.

Data rate të jetë te pakten 120Hz per spektra dhe sinjalet.

Drifti me pak se 0.5×10^{-3} AU/h

Dedektori duhet të ketë mundesi identifikimi automatik për qelizen e prurjes dhe per llampen(RFID) Lineariteti me shume se 2 AU ne 265nm

SOFTËARE

Softëare dhe aparatura e HPLC duhet të jetë nga i njëjti prodhues

Një PC dhe printer duhet të kontrollojë të gjithë modulet dhe të bëjë procesimin e të dhënave si, identifikimin e pikut, analizimin e të dhënave, kalibrimin, kuantifikimin dhe raportimin/ose ekuivalenti këtyre të dhënave

22. Kape kimike (1 copë)

Gjerësia 1100 mm - 1200 mm

Kapaciteti thithës mbi 1700 m³/ore

Syprina e punës me material antiacid

Suporti i jashtëm me strukture prej celiku te galvanizuar

Pajisur me lavaman me material celik inoks te integruar ne syprinën e punës

Pajisur me rubinet uji

Pajisur me te pakten 2 priza elektrike

Kabina duhet te kete ndricim

Pjesa ballore me xham sigurie te lëvizshëm, te laminuar te pakten 5mm

35. Furre Mufel (1 copë)

Furre mufel për përdorim laboratorik.

Materjali izolues duhet te jete lesh qeramike

Temperatura jo më e vogël se 550 °C

Vëllimi i furrës: jo me pak se 9L

Fuqia: maksimalisht 3kË

Koha e procesit: 1 minute - 99 ore 59 min

Termoelementi duhet te jete Ni – Cr Ni

Mundësi programimi me hapa 1°C

Kontrolli i temperatures te mundesohet me PID Dixhital kontrolli

Struktura e dhomes duhet te jete rezistente nga temperaturat e larta

BËHET

20. HPLC Ëith autosampler, DAD (1 copë)

Sistem HPLC Modular i perbere nga:

POMPA

Pompa duhet te kete degazues me të paktën 3-4 kanale Diapazoni i prurjes: të paktën 0.001-10mL/min

Precizioni ≤ 0.07 % RSD

Saktësia e prurjes të paktën ± 1%

Moduli të punojë me presion më shumë se 580 bar

Formimi i gradientit të bëhet me anë të përzjerjes në presion të ulët Kontrolli i çdo përbërësi të prurjes të ketë diapazon 0-100%

Pompë Kuaternare me dual piston ne seri

Saktësia e përberjes së prurjes < 0.2 % RSD Ky parameter ka te beje me precizionin e perberjes se prurjes dhe eshte nje nder parametrat e rendesishem te analizimit me pajisjen HPLC. Precizioni i perberjes eshte nje parameter qe plotesohet nga te gjithë prodhuesit Kompensimi i shtypjes te kete mundesi per tu zgjedhur nga perdoruesi Ph i rekomanduar 1-12.5

AUTOSAMPLER

Kapaciteti i autosamplerit >200 vialë nga 2 ml Zvogelimi i kapacitetit te autosamplerit ul rendimentin e laboratorit ne analize dhe rrit koston e laboratorit

Diapazoni i volumit të injektimit: 0.1-100uL

Carry Over: më pak se 0.003%

Moduli të punojë me presion deri në 800bar

Koha e ciklit të injektimit <10s

Precizioni i injektimit më pak se 0.15% RSD

TERMOSTATI I KOLONAVE

Moduli te kete kapacitet per te pakten 3 kolona prej 300mm.

Diapazoni i temperaturës: 10°C nën ambient deri ne 85°C

Me 2 zona temperature

Saktësia e temperaturës: ±0.5°C

Stabiliteti i temperatures: ±0.1°C ose me I ulet

Koha e ngrohjes: < 6 min nga ambienti ne 40°C Shpejtesia e ngrohjes se kolones ndikon ne kohen e analizave duke zvogeluar numrin total te tyre dhe ne kete menyre duke ulur rendimentin

Moduli të vijë i shoqëruar me një valvul 2 pozicione / 6porta

DAD

Dedektori duhet të ketë qelize matje 10mm

Diapazoni i gjatesise se vales 190-640 nm ose me gjere

Zhurma për qelize matje 10mm më e vogël se $\pm 3.2 \times 10^{-6}$

Dedektori duhet të ketë 1024-elemente diode me 8 sinjale.

Data rate të jetë te pakten 120Hz per spektra dhe sinjalet. Shpejtesia e marrjes se te dhenave eshte e rendesishme ne performancen e pikut. Vlera me me larta se 120Hz jane te mirepritura.

Drifti me pak se 0.5×10^{-3} AU/h

Dedektori duhet të ketë mundesi identifikimi automatik për qelizen e prurjes dhe per llampen (RFID) Lineariteti me shume se 2 AU ne 265nm

SOFTËARE

Softëare dhe aparatura e HPLC duhet të jetë nga i njëjti prodhues

Një PC dhe printer duhet të kontrollojë të gjithë modulet dhe të bëjë procesimin e të dhënave si, identifikimin e pikut, analizimin e të dhënave, kalibrimin, kuantifikimin dhe raportimin/ose ekuivalenti këtyre të dhënave

22. Kape kimike (1 copë)

Gjerësia 1100 mm - 1200 mm

Kapaciteti thithës mbi 1700 m³/ore

Syprina e punës me material antiacid

Suporti i jashtem me strukture prej celiku te galvanizuar
Pajisur me lavaman me material celik inoks te integruar ne syprinën e punës
Pajisur me rubinet uji
Pajisur me te pakten 2 priza elektrike
Kabina duhet te kete ndricim
Pjesa ballore me xham sigurie te lëvizshëm, te laminuar te pakten 5mm

35. Furre Mufel (1 copë)

Furre mufel për përdorim laboratorik.
Materjali izolues duhet te jete lesh qeramike
Temperatura jo më e vogël se 550 °C
Vëllimi i furrës: jo me pak se 9L
Fuqia: maksimalisht 3kË
Koha e procesit: 1 minute - 99 ore 59 min
Termoelementi duhet te jete Ni – Cr Ni
Mundësi programimi me hapa 1°C
Kontrolli i temperatures te mundesohet me PID Dixhital kontrolli
Struktura e dhomes duhet te jete rezistente nga temperaturat e larta

III.2.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “*Isometric*” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Katalog pajisje AKU P1. pdf
- Katalog pajisje AKU P2. Pdf
- Katalog shqip pajisje AKU. pdf

III.2.4. Në nenin 2 “*Qëllimi*” të ligjit nr.162/2022 “*Për Prokurimin Publik*” parashikohet se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.2.5. Neni 3 “*Parime të përgjithshme*” të ligjit nr.162/2022 “*Për Prokurimin Publik*” parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose

dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.6. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk

ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

III.2.7. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.2.8. Në nenin Neni 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.2.9. Në nenin 40, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.2.10. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore,

nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.2.11. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.2.12. Në përputhje me nenin 24 pika 3 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në marrjen e vendimeve mban parasysht, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit. Komisioni, në jurisprudencën e tij, e ka bërë pjesë të standardeve për një proces të rregullt ligjor edhe respektimin e parimit të kontradiktoritetit. Për sa më sipër, parimi i kontradiktoritetit, i parë në këndvështrimin e barazisë së armëve në procesin administrativ, është një evolucion logjik i të drejtës së palës për të marrë pjesë në gjykim dhe për t’u trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë nga një gjyqtar (arbitër) i drejtë dhe i paanshëm, i cili u garanton të dyja palëve të njëjtat mundësi, për të shpalosur provat dhe argumentet e tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në shqyrtimin administrativ, atëherë argumentet e njëjës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues dhe ligjor për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Ndaj për këtë qëllim, Komisioni organizoi një seancë dëgjimore mes palëve në lidhje me specifikimet teknike për artikullin me nr. 20, 22 dhe 35.*

III.2.13. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, KPP vëren, se autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike”, ka përcaktuar specifikimet teknike të cilat duhet të përmbushin produktet objekt-prokurimi. Gjithashtu, në “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.1.4 e “Kapacitetit teknik”, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë. (Katalogët duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT (Dokumentet duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara). KPP konstaton, se qëllimi i këtij kriteri është që nëpërmjet katalogëve të kërkuar, të verifikohen specifikimet teknike të produkteve të ofruara nga operatorët

ekonomikë, për të parë përputhshmërinë e tyre me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për këto artikuj.

III.2.14. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Isometric” SHPK, konstaton se, ky i fundit, për të plotësuar kriterin e mësipërm ka paraqitur katalogët e markuar për secilin artikull konkretisht katalog “Katalog pajisje AKU P1. Pdf”, “Katalog pajisje AKU P1. Pdf”, “Katalog shqip pajisje AKU. Pdf” (i përkthyer dhe i noterizuar).

Në kuadër të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke qenë se KPP shfaq vështirësi në evidentimin dhe verifikimin e specifikimeve teknike për të cilat operatori ekonomik ankimues “Almedical” SHPK pretendon, se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Isometric” SHPK, për disa nga artikujt, tek katalogët dhe dokumentacioni i paraqitur nga ky i fundit në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), KPP me anë të shkresë nr. 121/9 prot., datë 02.03.2023 i kërkoi operatorit ekonomik “Isometric” SHPK, me qëllim gjykimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, të dorëzohë pranë KPP-së informacionin dhe faktet, se në cilin katalog apo dokument (faqe, paragraf etj.), nga ato të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, gjenden artikujt me specifikimet teknike të lartpërmendura nga operatori ekonomik ankimues.

Me anë të shkresës së protokolluar me tonën me shkresën nr. 121/15 prot, datë 07.03.2023 operatori ekonomik, “Isometric” SHPK ka dërguar informacion pranë Komisionit Prokurimit Publik, në lidhje me objektin e kërkesës nr. 121/9 prot, datë 02.03.2023. Gjithashtu, KPP me shkresën nr. 121/18 prot, datë 13.03.2023 njoftoi operatorin ekonomik “Isometric” SHPK dhe autoritetin kontraktor, për zhvillimin e një seance dëgjimore më datë 15.03.2023 ora 12:00, për të bërë të mundur evidentimin dhe verifikimin e specifikimeve teknike në katalog me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit. Në ditën dhe orën e përcaktuar në shkresën e sipërcituar, u paraqitën pranë KPP-së përfaqësuesit e autoritetit kontraktor dhe përfaqësuesi i operatorit ekonomik “Isometric” SHPK.

III.2.15. Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, dokumentacioni i dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Isometric” SHPK, si dhe sqarimet e vetë këtij të fundit dorëzuar pranë KPP-së, konstatohet se operatori ekonomik “Isometric” SHPK ka paraqitur katalog të përkthyer dhe të noterizuar, në të cilin pasqyrohen të gjithë artikujt objekt-prokurimi, si dhe janë markuar sipas specifikimeve të kërkuara në DST për secilin nga artikujt. Gjithashtu, nga verifikimi i specifikimeve teknike për të cilat operatori ekonomik ankimues pretendon, se nuk përmbushen nga produktet e ofruara nga operatori ekonomik “Isometric” SHPK, konkretisht për pretendimet se **“Për artikullin me nr 20 HPLC With autosampler, DAD nuk plotëson specifikimet teknike si 1- Pompa duhet te kete degazues te integruar me të paktën 4 kanale Diapazoni i prurjes: të paktën 0.001- 10mL/min ; 2- Precizioni ≤ 0.07 % RSD; 3- Saktësia e prurjes të paktën $\pm 1\%$; 4- Moduli të punojë me presion më shumë se 580 bar; 5- Formimi i gradientit të bëhet me anë të përzjerjes në presion të ulët Kontrolli i çdo përbërësi të prurjes të ketë diapazon 0-100%; 6- Pompë Kuaternare me dual piston ne seri; 7- Saktësia e**

përberjes së prurjes < 0.2 % RSD; 8- Kompensimi i shtypjes te kete mundesi per tu zgjedhur nga perdoruesi Ph i rekomanduar 1-12.5; 9- Kapaciteti i autosamplerit > 200 vialle nga 2 ml; 10- Diapazoni i volumit të injektimit: 0.1-100 uL; 11- Carry Over: më pak se 0.003%; 12- Moduli të punojë me presion deri në 800 bar; 13- Koha e ciklit të injektimit < 10s; 14- Preçizioni i injektimit më pak se 0.15% RSD; 15- Moduli të ketë kapacitet për 3 kolona nga 300mm; 16- Diapazoni i temperaturës: 10°C nën ambient deri ne 85°C; 17- Me 2 zona temperature; 18- Saktësia e temperaturës: ±0.5°C; 19- Stabiliteti i temperatures: ±0.1°C ose me 1 mire; 20- Koha e ngrohjes: < 6 min nga ambienti ne 40°C; 21- Moduli të vijë i shoqëruar me një valvul 2 pozicione / 6porta; 22- Dedektori duhet të ketë qelize matje 10mm; 23- Diapazoni i gjatesise se vales 190-640 nm ose me mire; 24- Zhurma për qelize matje 10mm më e vogël se ±3.2 x 10⁻⁶; 25- Dedektori duhet të ketë 1024-elemente diode me 8 sinjale; 26- Data rate të jetë te pakten 120 Hz per spektra dhe sinjalet; 27- Drifti me pak se 0.5 x 10⁻³ AU/h; 28- Dedektori duhet të ketë mundesi identifikimi automatik për qelizen e prurjes dhe per llampen (RFID) Lineariteti me shume se 2 AU ne 265nm; 29- Softëare dhe aparatura e HPLC duhet të jetë nga i njëjti prodhues; 30- Një PC dhe printer duhet të kontrollojë të gjithë modulet dhe të bëjë procesimin e të dhënave si, identifikimin e pikut, analizimin e të dhënave, kalibrimin, kuantifikimin dhe raportimin/ose ekuivalenti këtyre të dhënave; **Për artikullin me nr 22. Kape kimike nuk plotëson specifikimet teknike si 1- Gjerësia 1100 mm - 1200 mm; 2- Kapaciteti thithës mbi 1700 m³/ore; 3- Syprina e punës me material antiacid; 4- Suporti i jashtem me strukture prej celiku te galvanizuar; 5- Pajisur me lavaman me material celik inoks te integruar ne syprinën e punës; 6- Pajisur me rubinet uji; 7- Pajisur me te pakten 2 priza elektrike; 8- Kabina duhet te kete ndricim; 9- Pjesa ballore me xham sigurie te lëvizshëm, te laminuar te pakten 5mm; Ndërsa për artikullin me nr. 35. Furre Mufel nuk plotëson specifikimet teknike si 1- Fuqia: maksimalisht 3kë; 2- Koha e procesit: 1 minute - 99 ore 59 min; 3- Termoelementi duhet te jete Ni – Cr Ni; 4- Kontrolli i temperatures te mundesohet me PID Dixhital kontrolli”, KPP nga verifikimi i katalogut të ngarkuar në SPE “Katalog pajisje AKU P2. Pdf”, për pajisjen me nr. 20 HPLC With autosampler, DAD nga prodhuesi Young In Chromoss (i përkthyer dhe i noterizuar), për pajisjen me nr. 22 Kape Kimike nga prodhuesi Comecta (i përkthyer dhe i noterizuar), për pajisjen me nr. 35 Furrë Mufel nga prodhuesi Labbox (i përkthyer dhe i noterizuar), konstaton, se për secilin artikull të mësipërm, operatori ekonomik “Isometric” SHPK, ka markuar në katalog specifikimet, të cilat janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Por për një gjykim sa më të drejtë dhe transparent të ankesës dhe për shkak të specifikës së kësaj procedurë prokurimi dhe vështirësisë në evidentimin e mënyrës së përmbushjes së specifikimeve teknike për artikulljt me nr. 20, 22 dhe 35, KPP në datën 15.03.2023, ora 12:00, në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik, zhvilloi një Seancë Dëgjimore midis operatorit ekonomik “Isometric” SHPK, përfaqësuesve të autoritetit kontraktor (anëtar i komisionit të vlerësimit të ofertave, njësisë së prokurimit dhe komisionit shqyrtimit të ankesave dhe anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik, ku për përfaqësuesin e operatorit ekonomik në prani dhe të përfaqësuesve të autoritetit kontraktor nga ana e KPP u shtruan pyetjet se në cilën faqe të katalogut të ngarkuar në SPE nga ana juaj plotësohen specifikimet teknike për të cilat ngrihen pretendime nga operatori ekonomik ankimes për produktin me nr rendor 20 HPLC With autosampler, DAD, **Përfaqësuesi i operatorit ekonomik z. N. C sqaron se: Specifikimi****

teknike për artikullin me nr rendor 20 HPLC Ëith autosampler, DAD, në katalogun e dorëzuar nga ana jonë në SPE me emërtesën Katalog Pajisje AKU P2 por dhe shpjegimet e paraqitura nga ana jonë sipas kërkesës tuaj evidentohen në këto faqe në katalog konkretisht:

- 1-** Pompa duhet te kete degazues te integruar me të paktën 4 kanale, ky specifikim gjëndet në faqen 6, fjalia 2 të katalogut ku evidentohet nga 4 kanale ne kemi paraqitur me 5 kanale;
- 2-** Diapazoni i prurjes: të paktën 0.001- 10mL/min, ky specifikim gjëndet në faqen 6 të katalogut fjalia 6.;
- 3-** Precizioni $\leq 0.07\%$ RSD, ky specifikim gjëndet në faqen 6 të katalogut, fjalia 8.;
- 4-** Saktësia e prurjes të paktën $\pm 1\%$, ky specifikim gjëndet në faqen 6 të katalogut fjalia 7, ku nga $\leq 0.07\%$ RSD, produkti ynë e ka $\leq 0.05\%$ RSD.;
- 5-** Moduli të punojë me presion më shumë se 580 bar, ky specifikim gjëndet në faqen 9 të katalogut fjalia 31, ku nga 580 bar, produkti ynë e ka 11600 psi, të cilën po ta konvertosh në bar si njësi matëse të kërkuar nga AK jep të njëjtin rezultat.;
- 6-** Formimi i gradientit të bëhet me anë të përzjerjes në presion të ulët Kontrolli i çdo përbërësi të prurjes të ketë diapazon 0-100%, ky specifikim gjëndet në faqen 6 të katalogut fjalia 16.;
- 7-** Pompë Kuaternare me dual piston ne seri, ky specifikim gjëndet në faqen 6 të katalogut fjalia 1 dhe 2.;
- 8-** Saktësia e përberjes së prurjes $< 0.2\%$ RSD, ky specifikim gjëndet në faqen 6 të katalogut fjalia 8, ku nga $\leq 0.2\%$ RSD, produkti ynë e ka $\leq 0.05\%$ RSD.;
- 9-** Kompensimi i shtypjes te kete mundesi per tu zgjedhur nga perdoruesi Ph i rekomanduar 1-12.5, ky specifikim gjëndet në faqen 6 të katalogut fjalia 18.;
- 10-** Kapaciteti i autosamplerit >200 viale nga 2 ml, ky specifikim gjëndet në faqen 9 të katalogut fjalia 18-19-20.;
- 11-** Diapazoni i volumit të injektimit: 0.1-100uL, ky specifikim gjëndet në faqen 9 të katalogut fjalia 22.;
- 12-** Carry Over: më pak se 0.003%, ky specifikim gjëndet në faqen 10 të katalogut fjalia 1.;
- 13-** Moduli të punojë me presion deri në 800 bar, ky specifikim gjëndet në faqen 9 të katalogut fjalia 31.;
- 14-** Koha e ciklit të injektimit $<10s$, ky specifikim gjëndet në faqen 9 të katalogut fjalia 26 dhe 28, ku nga $<10s$, produkti ynë e ka $<20s$.;
- 15-** Precizioni i injektimit më pak se 0.15% RSD, ky specifikim gjëndet në faqen 10 të katalogut fjalia 4.;
- 16-** Moduli të ketë kapacitet për 4 kolona nga 300 mm, ky specifikim gjëndet në faqen 8 të katalogut fjalia 22.;
- 17-** Diapazoni i temperaturës: $10^{\circ}C$ nën ambient deri ne $85^{\circ}C$, ky specifikim gjëndet në faqen 8 të katalogut fjalia 18.;
- 18-** Me 2 zona temperature, ky specifikim gjëndet në faqen 8 të katalogut fjalia 23.;
- 19-** Saktësia e temperaturës: $\pm 0.5^{\circ}C$, ky specifikim gjëndet në faqen 8 të katalogut fjalia 20, ku nga $\pm 0.5^{\circ}C$, produkti ynë e ka $\pm 0.3^{\circ}C$.;
- 20-** Stabiliteti i temperatures: $\pm 0.1^{\circ}C$ ose me i mire, ky specifikim gjëndet në faqen 8 të katalogut fjalia 19, ku nga $\pm 0.1^{\circ}C$, produkti ynë e ka $\pm 0.03^{\circ}C$.;
- 21-** Koha e ngrohjes: < 6 min nga ambienti ne $40^{\circ}C$, ky specifikim gjëndet në faqen 8 të katalogut fjalia 19, ku nga $\pm 0.1^{\circ}C$, produkti ynë e ka $\pm 0.03^{\circ}C$.;
- 22-** Moduli të vijë i shoqëruar me një valvul 2 pozicione / 6porta, ky specifikim gjëndet në faqen 8 të katalogut fjalia 19, ku nga $\pm 0.1^{\circ}C$, produkti ynë e ka $\pm 0.03^{\circ}C$.;
- 23-** Dedektori duhet të ketë qelize matje 10 mm, ky specifikim gjëndet në faqen 7 të katalogut fjalia 8.;
- 24-** Diapazoni i gjatesise se vales 190-640 nm ose me mire, ky specifikim gjëndet në faqen 7 të katalogut fjalia 5, ku nga 190-640nm, produkti ynë e ka 190-950.;
- 25-** Zhurma për qelize matje 10mm më e vogël se $\pm 3.2 \times 10^{-6}$, ky specifikim gjëndet në faqen 7, fjalia 13, të cilën po ta konvertosh del me vogël se vlera e kërkuar nga AK konkretisht $< \pm 1 \times 10^{-5}$.;
- 26-** Dedektori duhet të ketë 1024-elemente diode me 8 sinjale, ky specifikim gjëndet në faqen 7, fjalia 3 dhe 4.;
- 27-** Data rate të jetë te pakten 120Hz per spektra dhe sinjalet, ky specifikim gjëndet në faqen 7, fjalia 17 dhe 18. Aparati qe ne kemi ofertuar përbëhet nga 5 kanale ku konkretisht $5 \times 50 \text{ Hz} = 250 \text{ Hz}$,

pra e përfshin edhe atë që ka kërkuar AK.; **28-** Drifti me pak se 0.5×10^{-3} AU/h, ky specifikim gjëndet në faqen 7, fjalia 15, të cilën po ta konvertosh del me vogël se vlera e kërkuar nga AK konkretisht 0.2×10^{-3} AU/h, duke përfshirë edhe specifikimin e AK.; **29-** Dedektori duhet të ketë mundësi identifikimi automatik për qelizën e prurjes dhe për llampën (RFID) Lineariteti me shume se 2 AU në 265 nm, ky specifikim gjëndet në faqen 7, fjalia 14, duke e tejkualuar specifikimin e AK pasi saktësia 2AU fillon që në gjatësinë spektrale më të ulët nga 254 nm ndërkohë AK ka kërkuar të fillojë 265 nm, duke e përfshirë edhe specifikimin e AK.; **30-** Softëare dhe aparatura e HPLC duhet të jetë nga i njëjti prodhues, ky specifikim gjëndet në faqen 5.; **31-** Një PC dhe printer duhet të kontrollojë të gjithë modulet dhe të bëjë procesimin e të dhënave si, identifikimin e pikut, analizimin e të dhënave, kalibrimin, kuantifikimin dhe raportimin/ose ekuivalenti këtyre të dhënave, ky specifikim gjëndet në faqen 10 dhe 11 pjesët e markuara të katalogut.

KPP pyet OE: Në cilën faqe të katalogut të ngarkuar në SPE nga ana juaj plotësohen specifikimet teknike për të cilat ngrihen pretendime nga operatori ekonomik ankimes për produktin me nr rendor 22 Kape Kimike, **Përfaqësuesi i operatorit ekonomik z. N. C sqaron se:** Specifikimi teknike për artikullin me nr rendor 22 Kapë Kimike, në katalogun e dorëzuar nga ana jonë në SPE me emërtesën Katalog Pajisje AKU P2 por dhe shpjegimet e paraqitura nga ana jonë sipas kërkesës tuaj evidentohen në këto faqe në katalog konkretisht: **1-** Gjerësia 1100 mm - 1200 mm, ky specifikim gjëndet në faqen 16 të katalogut në tabelën e dimensioneve të markuar kodin përkatës VG-BS-1220.; **2-** Kapaciteti thithës mbi 1700 m³/ore, ky specifikim gjëndet në faqen 16, fjalia dytë tek paragrafi technical features. Aparati që ne kemi ofertuar tejkalon specifikimet teknike të kërkuara nga AK pasi kapaciteti thithës fillon nga 420 m/h dhe shkon deri në 4500 m³/h.; **3-** Syprina e punës me material antiacid, ky specifikim gjëndet në faqen 16, fjalia e parë e paragrafit të parë tek Common Features.; **4-** Suporti i jashtëm me strukture prej celiku të galvanizuar, ky specifikim gjëndet në faqen 16, fjalia e parë e paragrafit të parë tek Common Features.; **5-** Pajisur me lavaman me material celik inox të integruar në syprinën e punës, ky specifikim gjëndet në faqen 16, fjalia e parë e paragrafit të parë tek Common Features.; **6-** Pajisur me rubinet uji, ky specifikim gjëndet në faqen 16, fjalia e parë e paragrafit të katërt Control Panel.; **7-** Pajisur me të pakten 2 priza elektrike, ky specifikim gjëndet në faqen 16, fjalia e parë e paragrafit të katërt Control Panel. **8-** Kabina duhet të ketë ndricim, ky specifikim gjëndet në faqen 16, fjalia e parë e paragrafit të katërt Control Panel.; **9-** Pjesa ballore me xham sigurie të lëvizshëm, të laminuar të pakten 5mm, ky specifikim gjëndet në faqen 16, fjalia e parë e paragrafit të parë tek Common Features.

KPP pyet OE: Në cilën faqe të katalogut të ngarkuar në SPE nga ana juaj plotësohen specifikimet teknike për të cilat ngrihen pretendime nga operatori ekonomik ankimes për produktin me nr rendor 35 Furrë Mufel, **Përfaqësuesi i operatorit ekonomik z. N. C sqaron se:** Specifikimi teknike për artikullin me nr rendor 35 Furrë Mufel, në katalogun e dorëzuar nga ana jonë në SPE me emërtesën Katalog Pajisje AKU P2 por dhe shpjegimet e paraqitura nga ana jonë sipas kërkesës tuaj evidentohen në këto faqe në katalog konkretisht: **1-** Fuqia: maksimalisht 3kw, ky specifikim gjëndet në faqen 39 nga 3 Kë deri në 4.5 Kë, pra për sasinë e kërkuar nga AK 9 L të furrës pajisja jonë nuk e tejkalon konsumin e përcaktuar 3 Kë.; **2-** Koha e procesit: 1 minute - 99 ore 59 min, ky specifikim gjëndet në faqen 39 dhe nga 1 minute - 99 ore 59 min të kërkuara nga AK, pajisja jonë e ofron deri në 1-9999 min.; **3-**

Termoelementi duhet te jete Ni – Cr Ni, ky specifikim gjendet në faqen 39 të katalogut në paragrafin e trete fjalia e fundit, madje furra e ofruar nga ana jonë është e pajisur edhe me sensor platinum – rhodium sensor, sensor që ka temperaturë shumë herë më të lartë se një termocift bazik nikel-kromi.; 4- Kontrolli i temperatures te mundesohet me PID Digjital kontrolli, ky specifikim gjendet në faqen 39 të katalogut në paragrafin e trete fjalia e parë.

Sa më sipër, KPP nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimes, verifikimi i katalogëve të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Isometric” SHPK, sqarimeve dhe argumenteve të dorëzuara nga ky i fundit pranë KPP, si dhe deklarimeve të tij në seancën degjimore të mbajtur në datë 15.03.2023, KPP gjykon se, operatori ekonomik “Isometric” SHPK përmbush specifikimet teknike në lidhje me artikujt nr. 20, 22 dhe 35. Gjithashtu, vlen të theksojmë, se edhe specialistët e autoritetit kontraktor prezentë gjatë seancës degjimore znj. S. H, znj. M. D dhe znj. Z. C, deklaruan dhe evidentuan specifikimet teknike në katalogun e dorëzuar nga operatori ekonomik “Isometric” SHPK. Sa më sipër argumentuar, gjykojmë, se operatori ekonomik “Isometric” SHPK me anë të dokumentacionit të paraqitur vërteton, se artikujt e ofruar nga ky i fundit janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Almedical” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Gamma” SHPK me arsyet: “Ky operator ekonomik nuk përmbush specifikimet teknike për artikujt me nr 20, 22 dhe 35 konkretisht **Për artikullin me nr 20 HPLC With autosampler, DAD** nuk plotëson specifikimet teknike si **1-** Pompa duhet te kete degazues te integruar me të paktën 4 kanale Diapazoni i prurjes: të paktën 0.001- 10mL/min ; **2-** Precizioni $\leq 0.07\%$ RSD; **3-** Saktësia e prurjes të paktën $\pm 1\%$; **4-** Moduli të punojë me presion më shumë se 580 bar; **5-** Formimi i gradientit të bëhet me anë të përzjerjes në presion të ulët **Kontrolli i çdo përbërësi të prurjes të ketë diapazon 0-100%**; **6-** Pompë Kuaternare me dual piston ne seri; **7-** Saktësia e përberjes së prurjes $< 0.2\%$ RSD; **8-** Kompensimi i shtypjes te kete mundesi per tu zgjedhur nga perdoruesi Ph i rekomanduar 1-12.5; **9-** Kapaciteti i autosamplerit > 200 viale nga 2 ml; **10-** Diapazoni i volumit të injektimit: 0.1-100 uL; **11-** Carry Over: më pak se 0.003%; **12-** Moduli të punojë me presion deri në 800 bar; **13-** Koha e ciklit të injektimit $< 10s$; **14-** Preçizioni i injektimit më pak se 0.15% RSD; **15-** Moduli të ketë kapacitet për 3 kolona nga 300mm; **16-** Diapazoni i temperaturës: 10°C nën ambient deri ne 85°C; **17-** Me 2 zona temperature; **18-** Saktësia e temperaturës: $\pm 0.5^\circ C$; **19-** Stabiliteti i temperatures: $\pm 0.1^\circ C$ ose me 1 mire; **20-** Koha e ngrohjes: < 6 min nga ambienti ne 40°C; **21-** Moduli të vijë i shoqëruar me një valvul 2 pozicione / 6porta; **22-** Dedektori duhet të ketë qelize matje 10mm; **23-** Diapazoni i gjatesise se vales 190-640 nm ose me mire; **24-** Zhurma për qelize matje 10mm më e vogël se $\pm 3.2 \times 10^{-6}$; **25-** Dedektori duhet të ketë 1024-elemente diode me 8 sinjale; **26-** Data rate të jetë te pakten 120 Hz per spektra dhe sinjalet; **27-** Drifti me pak se 0.5×10^{-3} AU/h; **28-** Dedektori duhet të ketë mundesi identifikimi automatik për qelizen e prurjes dhe per llampen (RFID) **Lineariteti me shume se 2 AU ne 265nm**; **29-** Softëare dhe aparatura e HPLC duhet të jetë nga i njëjti prodhues; **30-** Një PC dhe printer duhet të kontrollojë të gjithë modulet dhe të bëjë procesimin e të dhënave si, identifikimin e pikut, analizimin e të dhënave, kalibrimin, kuantifikimin dhe raportimin/ose ekuivalenti këtyre të dhënave; **Për artikullin me nr 22. Kape kimike** nuk plotëson specifikimet teknike si **1-** Gjerësia 1100 mm - 1200 mm; **2-** Kapaciteti

thithës mbi 1700 m³/ore; 3- Syprina e punës me material antiacid; 4- Suporti i jashtëm me strukture prej celiku te galvanizuar; 5- Pajisur me lavaman me material celik inoks te integruar ne syprinën e punës; 6- Pajisur me rubinet uji; 7- Pajisur me te pakten 2 priza elektrike; 8- Kabina duhet te kete ndricim; 9- Pjesa ballore me xham sigurie te lëvizshëm, te laminuar te pakten 5mm; **Ndërsa për artikullin me nr. 35. Furre Mufel nuk plotëson specifikimet teknike si**
1- Fuqia: maksimalisht 3kë; 2- Koha e procesit: 1 minute - 99 ore 59 min; 3- Termoelementi duhet te jete Ni – Cr Ni; 4- Kontrolli i temperatures te mundesohet me PID Dixhital kontrolli”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Komisioni Prokurimit Publik nga verifikimet e kryera në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik konstatoi, se në seksionin e posaçëm me titull përjashtimi i operatorëve ekonomikë gjendet vendimi Nr. 01, datë 11.01.2023 me përmbajtje si vijon: “Agjencia e Prokurimit Publik në mbështetje të nenit 78/1 a të Ligjit 162/2020 Për prokurimin publik në ushtrim të kompetencave të saj ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik “Gamma” SHPK me NUIS K31510153H, nga e drejta për të fituar kontrata publike për dorëzim të dokumenteve që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje tuba për marrjen e kampionëve të gjakut dhe materiale konsumi për laboratorin” të zhvilluar nga Spitali Rajonal Elbasan në datën 27.07.2022, me nr. REF 33019-06-15-2022, me fond limit 15,295,335.2 lekë pa TVSH.

APP i ushtron detyrat dhe kompetencat e saj në bazë dhe për zbatim të nenit 23 të LPP.

Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ: “Gamma” SHPK, më NUIS K31510153H me adresë: Rruga “Dervish Hekali” Nd. Nr. 8, Tiranë.

I. Arsyet e fillimit të procedimit administrativ

Procedimi administrativ ndaj operatorit ekonomik “Gamma” SHPK, ka nisur për dorëzim të dokumenteve, që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, me kërkesë të Spitalit Rajonal Elbasan, si edhe të Komisionit të Prokurimit Publik ka nisur bazuar në Vendimin Nr.508 prot., datë 06.11.2020 të dërguar nga Komisioni i Prokurimit Publik, i cili ka kërkuar nisjen e hetimit administrativ për konstatimet e bëra në këtë vendim.

II. Gjetjet:

Në përfundim të procedimit adminsitrativ të nisur u arrit në konkluzionin, se ndodheshim në kushtet e parashikuara në nenin 78/1 të LPP, në të cilën përcaktohet se: “1 Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike për një periudhë nga 3 muaj deri në 3 vjetë për a) keqinformim dhe dorëzim të dokumentave që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi”.

III. Masat:

Me vendimin Nr. 01 datë 11.01.2023, APP ka vendosur të përjashtojë operatorin ekonomik “Gamma” SHPK me NUIS K31510153H, nga e drejta për të fituar kontrata publike për 12 (dymbëdhjetë) muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

III.3.2. Gjithashtu, në Buletinin e Njoftimeve Publike Nr. 4 datë 16 Janar 2023 rezulton, se operatori ekonomik i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me emër “Gamma” SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NIPT K31510153H, me seli në Tiranë, përjashtohet – 12 (dymbëdhjetë) muaj (duke filluar nga data 11.01.2023-11.01.2024).

I njëjti status vijon të jetë edhe në Buletinin e Njoftimeve Publike Nr. 30 datë 03 Prill 2023.

III.3.3. Neni 129 “Procedura e hetimit administrativ” i ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se:

“Agjencia e Prokurimit Publik kryen hetim administrativ:

a) për verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë së procedurave të prokurimit publik, pasi ka përfunduar procedura me nënshkrimin e kontratës së prokurimit, por, në çdo rast, jo më vonë se 3 vjet nga nënshkrimi i saj;

b) për verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë së procedurave të anuluar, por, në çdo rast, jo më vonë se 3 vjet nga anulimi i tyre;

c) **për përjashtimin e një operatori ekonomik nga fitimi i kontratave publike, në çdo rast, jo më vonë se 3 vjet nga shkaktimi i situatës për të cilën kërkohet përjashtimi;**

ç) për monitorimin e zbatimit të kontratës së nënshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i nënshkrimit të kontratës dhe jo më vonë se 3 vjet nga përfundimi i zbatimit të saj”.

III.3.4. Neni 94 “Paraqitja e Ankesave” i VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet shprehimisht se: “Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Operatori ekonomik ankimues duhet të dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik”.

III.3.5. Në nenin 76 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

I. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) falsifikim;

e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;

b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;

c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;

ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji;

c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;

e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji.

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.

g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutuar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raportin në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim. Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një vepr penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera. Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. *Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit apo koncesionit, nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.*

III.3.6. Në interpretim të dispozitës ligjore të sipërcituar, del qartë qëllimi i normës juridike lidhur me të drejtën që gëzojnë operatorët ekonomikë për të ankimuar çdolloj vendimi të marrë nga autoriteti kontraktor, i cili ka dëmtuar ose rrezikon të dëmtojë interesat e tyre në procedurat e prokurimit. Nga shqyrtimi i ankesës të paraqitur nga ankimuesi konstatohet, se ky i fundit kundërshton vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Gamma” SHPK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, por ndërkohë nga verifikimi në Buletinin nr. 30, datë 03.04.2023, të Agjencisë së Prokurimit Publik, rezulton, se statusi i ankimuesit sikundër pasqyruar më sipër, të jetë i përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike me vendimin Nr. 01, datë 11.01.2023, për 12 muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Konkretisht, sipas të dhënave të pasqyruara më lart, vendimi shtrin efektet e tij nga **data 11.01.2023-11.01.2024**. Në këtë kuadër, Komisioni do të ndalet në një interpretim më të zgjeruar të pikës 3 të dispozitës së referuar përcaktimit ligjor më sipër cituar. Ligjvënësi ka përcaktuar, që mjafton që të provohet se operatori ekonomik ka paraqitur të dhëna të rreme me qëllim kualifikimin e tij në një procedurë prokurimi, dhe me vendim të Agjencisë Prokurimit Publik, ai përjashtohet nga fitimi i kontratave publike për një periudhe të caktuar siç dhe parashikon ligji për prokurimin publik. Qëllimi i ligjit të Prokurimit Publik është të përjashtojë nga e drejta e fitimit të fondeve publike, operatorë ekonomikë, që për qëllime kualifikimi në një procedurë prokurimi, paraqesin të dhëna të rreme të cilat janë konstatuar në shkelje administrative në përputhje me ligjin “Për prokurimin publik” nga Agjencia e Prokurimit Publik. Akoma më tej, duke parë qëllimin e ligjit, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, që hetimi për shkeljet e pretenduara ka nisur në një periudhë të mëparshme, ndërkohë që vendimi për përjashtimin e tij është marrë sërish përpara se operatori ekonomik ankimues “Almedical” SHPK të dorëzonte ankesën si pranë autoritetit kontraktor ashtu dhe pranë Komisionit prokurimit Publik. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, në interpretim të nenit 94, të ligjit nr.162/2020, gjykon se del qartë qëllimi i normës juridike lidhur me të drejtën që gëzojnë operatorët ekonomikë për të ankimuar çdolloj vendimi të marrë nga autoriteti kontraktor, i cili ka dëmtuar ose rrezikon të dëmtojë interesat e tyre në procedurat e prokurimit. Nga shqyrtimi i ankesës të paraqitur nga ankimuesi konstatohet, se ky i fundit kundërshton vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e një operatori ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike me vendimin Nr. 01, datë 11.01.2023, për 12 muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, por ndërkohë si para ashtu dhe pas paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, statusi i operatorit ekonomik “Gamma” SHPK për të cilin ngre pretendime operatori ekonomik ankimues “Almedical” SHPK, rezulton të jetë i përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se pretendimet e paraqitura nga operatori ekonomik ankimues “Almedical” SHPK në ankesë për operatorin ekonomik “Gamma” SHPK, nuk do të merren në shqyrtim, pasi referuar vendimit të marrë nga Agjencia e Prokurimit Publik në cilësinë e institucionit përgjegjës të ngarkuar nga ligji për përjashtimin

e operatorëve ekonomikë për fitimin e kontratave publike, operatori ekonomik “Gamma” SHPK në momentin e shqyrtimit të ankesës, rezulton i përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike. Në këtë kuptim, pretendimet e ankimuesit për kualifikimin e tij të padrejtë nga ana e autoritetit kontraktor nuk merren në shqyrtim nga KPP, pasi operatorit ekonomik “Gamma” SHPK i është hequr e drejta e fitimit të kontratave publike për periudhën 12 muaj, e rrjedhimisht ai nuk legjitimohet as për të paraqitur ankesa për procedurat e prokurimit publik dhe as për të lidhur kontrata publike gjatë kësaj periudhe, për shkak se ai në asnjë moment nuk mund të jetë fitues i mundshëm i kontratës publike. Për rrjedhojë në rastin konkret interesat e operatorit ekonomik ankimues nuk mund të rrezikohen apo dëmtohen nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, për sa kohë që operatori për të cilin ngre pretendim nuk mund të jetë fitues në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

Për sa më sipër pretendimet e ankimuesit nuk merren në shqyrtim.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Almedical” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Krijon” SHPK me arsyet: “Ky operator ekonomik nuk përmbush specifikimet teknike për artikujt me nr 20, 22 dhe 35 konkretisht **Për artikullin me nr 20 HPLC With autosampler, DAD** nuk plotëson specifikimet teknike si **1- Pompa duhet te kete degazues te integruar me të paktën 4 kanale Diapazoni i prurjes: të paktën 0.001- 10mL/min ; 2- Precizioni ≤ 0.07 % RSD; 3- Saktësia e prurjes të paktën $\pm 1\%$; 4- Moduli të punojë me presion më shumë se 580 bar; 5- Formimi i gradientit të bëhet me anë të përzjerjes në presion të ulët Kontrolli i çdo përbërësi të prurjes të ketë diapazon 0-100%; 6- Pompë Kuarternare me dual piston ne seri; 7- Saktësia e përberjes së prurjes < 0.2 % RSD; 8- Kompensimi i shtypjes te kete mundesi per tu zgjedhur nga perdoruesi Ph i rekomanduar 1-12.5; 9- Kapaciteti i autosamplerit > 200 viale nga 2 ml; 10- Diapazoni i volumit të injektimit: 0.1-100 uL; 11- Carry Over: më pak se 0.003%; 12- Moduli të punojë me presion deri në 800 bar; 13- Koha e ciklit të injektimit < 10 s; 14- Precizioni i injektimit më pak se 0.15% RSD; 15- Moduli të ketë kapacitet për 3 kolona nga 300mm; 16- Diapazoni i temperaturës: 10°C nën ambient deri ne 85°C; 17- Me 2 zona temperature; 18- Saktësia e temperaturës: ± 0.5 °C; 19- Stabiliteti i temperatures: ± 0.1 °C ose me 1 mire; 20- Koha e ngrohjes: < 6 min nga ambienti ne 40°C; 21- Moduli të vijë i shoqëruar me një valvul 2 pozicione / 6porta; 22- Dedektori duhet të ketë qelize matje 10mm; 23- Diapazoni i gjatesise se vales 190-640 nm ose me mire; 24- Zhurma për qelize matje 10mm më e vogël se $\pm 3.2 \times 10^{-6}$; 25- Dedektori duhet të ketë 1024-elemente diode me 8 sinjale; 26- Data rate të jetë te pakten 120 Hz per spektra dhe sinjalet; 27- Drifti me pak se 0.5×10^{-3} AU/h; 28- Dedektori duhet të ketë mundesi identifikimi automatik për qelizen e prurjes dhe per llampen (RFID) Lineariteti me shume se 2 AU ne 265nm; 29- Softëare dhe aparatura e HPLC duhet të jetë nga i njëjti prodhues; 30- Një PC dhe printer duhet të kontrollojë të gjithë modulet dhe të bëjë procesimin e të dhënave si, identifikimin e pikut, analizimin e të dhënave, kalibrimin, kuantifikimin dhe raportimin/ose ekuivalenti këtyre të dhënave; **Për artikullin me nr 22. Kape kimike** nuk plotëson specifikimet teknike si **1- Gjerësia 1100 mm - 1200 mm; 2- Kapaciteti thithës mbi 1700 m³/ore; 3- Syprina e punës me material antiacid; 4- Suporti i jashtem me strukture prej celiku te galvanizuar; 5- Pajisur me lavaman me material celik inoks te integruar ne syprinën e punës; 6- Pajisur me****

rubinet uji; 7- Pajisur me te pakten 2 priza elektrike; 8- Kabina duhet te kete ndricim; 9- Pjesa ballore me xham sigurie te lëvizshëm, te laminuar te pakten 5mm; **Ndërsa për artikullin me nr. 35. Furre Mufel nuk plotëson specifikimet teknike si 1- Fuqia: maksimalisht 3kë; 2- Koha e procesit: 1 minute - 99 ore 59 min; 3- Termoelementi duhet te jete Ni – Cr Ni; 4- Kontrolli i temperatures te mundesohet me PID Dixhital kontrolli**”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 7/2 “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, pika 2.1.4 “*Kapaciteti Teknik*”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.1.4. *Operatori ekonomik të paraqesë katalog teknik të mallit, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar. Në katalogë duhet të markohen (për lehtësi identifikimi) specifikimet teknike, të përcaktuara në Shtojcën 5 të DT.*

III.4.2. Në shtojcën 5 “*Formulari i Specifikimeve Teknike*” të modifikuar në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

ISHTE

20. HPLC With autosampler, DAD (1 copë)

Sistem HPLC Modular i perbere nga:

POMPA

Pompa duhet te kete degazues te integruar me të paktën 4 kanale Diapazoni i prurjes: të paktën 0.001- 10mL/min

Precizioni $\leq 0.07\%$ RSD

Saktësia e prurjes të paktën $\pm 1\%$

Moduli të punojë me presion më shumë se 580 bar

Formimi i gradientit të bëhet me anë të përzjerjes në presion të ulët Kontrolli i çdo përbërësi të prurjes të ketë diapazon 0-100%

Pompë Kuaternare me dual piston ne seri

Saktësia e përberjes së prurjes $< 0.2\%$ RSD

Kompensimi i shtypjes te kete mundesi per tu zgjedhur nga perdoruesi Ph i rekomanduar 1-12.5

AUTOSAMPLER

Kapaciteti i autosamplerit >200 viale nga 2 ml

Diapazoni i volumit të injektimit: 0.1-100uL

Carry Over: më pak se 0.003%

Moduli të punojë me presion deri në 800bar

Koha e ciklit të injektimit <10 s

Precizioni i injektimit më pak se 0.15% RSD

TERMOSTATI I KOLONAVE

Moduli të ketë kapacitet për 3 kolona nga 300mm

Diapazoni i temperaturës: 10°C nën ambient deri ne 85°C

Me 2 zona temperature

Saktësia e temperaturës: $\pm 0.5^{\circ}\text{C}$

Stabiliteti i temperaturës: $\pm 0.1^{\circ}\text{C}$ ose me 1 mire

Koha e ngrohjes: < 6 min nga ambienti ne 40°C

Moduli të vijë i shoqëruar me një valvul 2 pozicione / 6porta

DAD

Dedektori duhet të ketë qelize matje 10mm

Diapazoni i gjatesise se vales 190-640 nm ose me mire

Zhurma për qelize matje 10mm më e vogël se $\pm 3.2 \times 10^{-6}$

Dedektori duhet të ketë 1024-elemente diode me 8 sinjale.

Data rate të jetë te pakten 120Hz per spektra dhe sinjalet.

Drifti me pak se 0.5×10^{-3} AU/h

Dedektori duhet të ketë mundesi identifikimi automatik për qelizen e prurjes dhe per llampen(RFID) Lineariteti me shume se 2 AU ne 265nm

SOFTËARE

Softëare dhe aparatura e HPLC duhet të jetë nga i njëjti prodhues

Një PC dhe printer duhet të kontrollojë të gjithë modulet dhe të bëjë procesimin e të dhënave si, identifikimin e pikut, analizimin e të dhënave, kalibrimin, kuantifikimin dhe raportimin/ose ekuivalenti këtyre të dhënave

22. Kape kimike (1 copë)

Gjerësia 1100 mm - 1200 mm

Kapaciteti thithës mbi 1700 m³/ore

Syprina e punës me material antiacid

Suporti i jashtem me strukture prej celiku te galvanizuar

Pajisur me lavaman me material celik inoks te integruar ne syprinën e punës

Pajisur me rubinet uji

Pajisur me te pakten 2 priza elektrike

Kabina duhet te kete ndricim

Pjesa ballore me xham sigurie te lëvizshëm, te laminuar te pakten 5mm

35. Furre Mufel (1 copë)

Furre mufel për përdorim laboratorik.

Materjali izolues duhet te jete lesh qeramike

Temperatura jo më e vogël se 550°C

Vëllimi i furrës: jo me pak se 9L

Fuqia: maksimalisht 3kË

Koha e procesit: 1 minute - 99 ore 59 min

Termoelementi duhet te jete Ni – Cr Ni

Mundësi programimi me hapa 1°C

Kontrolli i temperaturës te mundesohet me PID Dixhital kontrolli

Struktura e dhomes duhet te jete rezistente nga temperaturat e larta

BËHET

20. HPLC Ëith autosampler, DAD (1 copë)

Sistem HPLC Modular i perbere nga:

POMPA

Pompa duhet te kete degazues me të paktën 3-4 kanale Diapazoni i prurjes: të paktën 0.001-10mL/min

Precizioni ≤ 0.07 % RSD

Saktësia e prurjes të paktën ± 1 %

Moduli të punojë me presion më shumë se 580 bar

Formimi i gradientit të bëhet me anë të përzjerjes në presion të ulët Kontrolli i çdo përbërësi të prurjes të ketë diapazon 0-100%

Pompë Kuaternare me dual piston ne seri

Saktësia e përberjes së prurjes < 0.2 % RSD Ky parameter ka te beje me precizionin e perberjes se prurjes dhe eshte nje nder parametrat e rendesishem te analizimit me pajisjen

HPLC. Precizioni i perberjes eshte nje parameter qe plotesohet nga te gjithë prodhuesit

Kompensimi i shtypjes te kete mundesi per tu zgjedhur nga perdoruesi Ph i rekomanduar 1-12.5

AUTOSAMPLER

Kapaciteti i autosamplerit >200 vialë nga 2 ml Zvogelimi i kapacitetit te autosamplerit ul rendimentin e laboratorit ne analize dhe rrit koston e laboratorit

Diapazoni i volumit të injektimit: 0.1-100uL

Carry Over: më pak se 0.003%

Moduli të punojë me presion deri në 800bar

Koha e ciklit të injektimit <10 s

Precizioni i injektimit më pak se 0.15% RSD

TERMOSTATI I KOLONAVE

Moduli te kete kapacitet per te pakten 3 kolona prej 300mm.

Diapazoni i temperaturës: 10°C nën ambient deri ne 85°C

Me 2 zona temperature

Saktësia e temperaturës: ± 0.5 °C

Stabiliteti i temperatures: ± 0.1 °C ose me I ulet

Koha e ngrohjes: < 6 min nga ambienti ne 40°C Shpejtesia e ngrohjes se kolones ndikon ne kohen e analizave duke zvogeluar numrin total te tyre dhe ne kete menyre duke ulur rendimentin

Moduli të vijë i shoqëruar me një valvul 2 pozicione / 6porta

DAD

Dedektori duhet të ketë qelize matje 10mm

Diapazoni i gjatesise se vales 190-640 nm ose me gjere

Zhurma për qelize matje 10mm më e vogël se $\pm 3.2 \times 10^{-6}$

Dedektori duhet të ketë 1024-elemente diode me 8 sinjale.

Data rate të jetë te pakten 120Hz per spektra dhe sinjalet. Shpejtesia e marrjes se te dhenave eshte e rendesishme ne performancen e pikut. Vlera me me larta se 120Hz jane te mirepritura.

Drifti me pak se 0.5×10^{-3} AU/h

Dedektori duhet të ketë mundësi identifikimi automatik për qelizën e prurjes dhe për llampën (RFID) Lineariteti me shumë se 2 AU në 265nm

SOFTËARE

Softëare dhe aparatura e HPLC duhet të jetë nga i njëjti prodhues

Një PC dhe printer duhet të kontrollojë të gjithë modulet dhe të bëjë procesimin e të dhënave si, identifikimin e pikut, analizimin e të dhënave, kalibrimin, kuantifikimin dhe raportimin/ose ekuivalenti këtyre të dhënave

22. Kape kimike (1 copë)

Gjerësia 1100 mm - 1200 mm

Kapaciteti thithës mbi 1700 m³/ore

Syprina e punës me material antiacid

Suporti i jashtëm me strukture prej celiku të galvanizuar

Pajisur me lavaman me material celik inoks të integruar në syprinën e punës

Pajisur me rubinet uji

Pajisur me të pakten 2 priza elektrike

Kabina duhet të ketë ndricim

Pjesa ballore me xham sigurie të lëvizshëm, të laminuar të pakten 5mm

35. Furre Mufel (1 copë)

Furre mufel për përdorim laboratorik.

Materjali izolues duhet të jetë lesh qeramike

Temperatura jo më e vogël se 550 °C

Vëllimi i furrës: jo më pak se 9L

Fuqia: maksimalisht 3kw

Koha e procesit: 1 minute - 99 ore 59 min

Termoelementi duhet të jetë Ni – Cr Ni

Mundësi programimi me hapa 1°C

Kontrolli i temperaturës të mundësohet me PID Dixhital kontrolli

Struktura e dhomës duhet të jetë rezistente nga temperaturat e larta

III.4.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Krijon” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Katalog 22 Equiplabo. pdf
- Katalog 10 Mimsal. pdf
- Katalog 3 Labstac. pdf
- Katalog 33 Hanna Instruments. pdf
- Katalog 9.29.34 Sartorius. pdf
- Katalog 28 FMT. pdf
- Katalog 16.23.24 Velp. Pdf

- Katalog 37 AT2E. pdf
- Katalog 35 Snol. pdf
- Katalog 17.36 Radëag. pdf
- Katalog 26 Rypa. pdf
- Katalog 40 Testo. pdf
- Katalog 15 Lactoscan. pdf
- Katalog 12.1.2 Nuve. pdf
- Katalog 31.11 Biobase. pdf
- Katalog 32 Labtech. pdf
- Katalog 30.5 Optika. pdf
- Katalog 19 Mindray. pdf
- Katalog 27 Nuve. pdf
- Katalog 39 Hecht. pdf
- Katalog 6.7.8 Memmert. pdf
- Katalog 13 Gerber. pdf
- Katalog 21 Biobase. pdf
- Katalog 18 Hettich. pdf
- Katalog 38 Ekosafe. pdf
- Katalog 4 Analytik-Jena. pdf
- Katalog 14 Astor. pdf
- Katalog 20 Thermo Scientific. pdf
- Katalog 25 Hanon. pdf

III.4.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.4.5. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.4.6. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

III.4.7. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve,

duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.4.8. Në nenin Neni 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.4.9. Në nenin 40, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.4.10. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë

përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.4.11. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.4.12. Në përputhje me nenin 24 pika 3 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në marrjen e vendimeve mban parasysht, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe eficientësinë, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit”*. Komisioni, në jurisprudencën e tij, e ka bërë pjesë të standardeve për një proces të rregullt ligjor edhe respektimin e parimit të kontradiktoritetit. Për sa më sipër, parimi i kontradiktoritetit, i parë në këndvështrimin e barazisë së armëve në procesin administrativ, është një evolucion logjik i të drejtës së palës për të marrë pjesë në gjykim dhe për t’u trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë nga një gjyqtar (arbitër) i drejtë dhe i paanshëm, i cili u garanton të dyja palëve të njëjtat mundësi, për të shpalosur provat dhe argumentet e tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në shqyrtimin administrativ, atëherë argumentet e njëjës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues dhe ligjor, për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Ndaj për këtë qëllim, Komisioni organizoi një seancë dëgjimore mes palëve në lidhje me specifikimet teknike për artikullin me nr. 20, 22 dhe 35.

III.4.13. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, KPP vëren, se autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike”, ka përcaktuar specifikimet teknike të cilat duhet të përmbushin produktet objekt-prokurimi. Gjithashtu, në “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.1.4 e “Kapacitetit teknik”, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë. (Katalogët duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT (Dokumentet duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara). KPP konstaton, se qëllimi i këtij kriteri është që nëpërmjet katalogëve të kërkuar, të verifikohen specifikimet teknike të produkteve të ofruara nga operatorët

ekonomikë, për të parë përputhshmërinë e tyre me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për këto artikuj.

III.4.14. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Krijon” SHPK, konstaton, se ky i fundit, për të plotësuar kriterin e mësipërm, ka paraqitur katalogët e markuar për secilin artikull, konkretisht për artikullin nr. 20, katalogun “Katalog 20 Thermo Scientific. Pdf”, për artikullin nr. 22 katalogun “Katalog 22 Equiplabo. Pdf”, për artikullin nr. 35 katalogun “Katalog 35 Snol. Pdf”. Në kuadër të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke qenë se KPP shfaq vështirësi në evidentimin dhe verifikimin e specifikimeve teknike për të cilat operatori ekonomik ankimues “Almedical” SHPK pretendon, se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Krijon” SHPK për disa nga artikujt, tek katalogët dhe dokumentacioni i paraqitur nga ky i fundit në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), KPP me anë të shkresës nr. 121/10 prot., datë 02.03.2023, i kërkoi operatorit ekonomik “Krijon” SHPK, me qëllim gjykimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, të dorëzohë pranë KPP-së informacionin dhe faktet, se në cilin katalog apo dokument (faqe, paragraf etj.), nga ato të dorëzuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik, gjenden artikujt me specifikimet teknike të lartpërmendura nga operatori ekonomik ankimues.

Me anë të shkresës së protokolluar me tonën me shkresën nr. 121/145 prot, datë 07.03.2023, operatori ekonomik “Krijon” SHPK ka dërguar informacion pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në lidhje me objektin e kërkesës nr. 121/10 prot, datë 02.03.2023. Gjithashtu, KPP me shkresën nr. 121/17 prot, datë 13.03.2023, njoftoi operatorin ekonomik “Krijon” SHPK dhe autoritetin kontraktor, për zhvillimin e një seance dëgjimore më datë 15.03.2023, ora 12:30, për të bërë të mundur evidentimin dhe verifikimin e specifikimeve teknike në katalog, me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit. Në ditën dhe orën e përcaktuar në shkresën e sipërcituar, u paraqitën pranë KPP-së përfaqësuesit e autoritetit kontraktor dhe përfaqësuesi i operatorit ekonomik “Krijon” SHPK.

III.4.15. Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, dokumentacioni i dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Krijon” SHPK, si dhe sqarimet e vetë këtij të fundit dorëzuar pranë KPP-së, konstatohet, se operatori ekonomik “Krijon” SHPK ka paraqitur katalogët përkatës për artikujt e kërkuar, në të cilin pasqyrohen të gjithë artikujt objekt-prokurimi, si dhe janë markuar specifikimet teknike të kërkuara në DST për secilin nga artikujt. Gjithashtu, nga verifikimi i specifikimeve teknike për të cilat operatori ekonomik ankimues pretendon se nuk përmbushen nga produktet e ofruara nga operatori ekonomik “Krijon” SHPK, konkretisht për pretendimet se **“Për artikullin me nr 20 HPLC Ëith autosampler, DAD nuk plotëson specifikimet teknike si 1- Pompa duhet te kete degazues te integruar me të paktën 4 kanale Diapazoni i prurjes: të paktën 0.001- 10mL/min ; 2- Precizioni $\leq 0.07\%$ RSD; 3- Saktësia e prurjes të paktën $\pm 1\%$; 4- Moduli të punojë me presion më shumë se 580 bar; 5- Formimi i gradientit të bëhet me anë të përzjerjes në presion të ulët Kontrolli i çdo përbërësi të prurjes të ketë diapazon 0-100%; 6- Pompë Kuaternare me dual piston ne seri; 7- Saktësia e përberjes së prurjes < 0.2**

% RSD; **8-** Kompensimi i shtypjes te kete mundesi per tu zgjedhur nga perdoruesi Ph i rekomanduar 1-12.5; **9-** Kapaciteti i autosamplerit > 200 vialë nga 2 ml; **10-** Diapazoni i volumit të injektimit: 0.1-100 uL; **11-** Carry Over: më pak se 0.003%; **12-** Moduli të punojë me presion deri në 800 bar; **13-** Koha e ciklit të injektimit < 10s; **14-** Preçizioni i injektimit më pak se 0.15% RSD; **15-** Moduli të ketë kapacitet për 3 kolona nga 300mm; **16-** Diapazoni i temperaturës: 10°C nën ambient deri ne 85°C; **17-** Me 2 zona temperature; **18-** Saktësia e temperaturës: ±0.5°C; **19-** Stabiliteti i temperatures: ±0.1°C ose me 1 mire; **20-** Koha e ngrohjes: < 6 min nga ambienti ne 40°C; **21-** Moduli të vijë i shoqëruar me një valvul 2 pozicione / 6porta; **22-** Dedektori duhet të ketë qelize matje 10mm; **23-** Diapazoni i gjatesise se vales 190-640 nm ose me mire; **24-** Zhurma për qelize matje 10mm më e vogël se ±3.2 x 10⁻⁶; **25-** Dedektori duhet të ketë 1024-elemente diode me 8 sinjale; **26-** Data rate të jetë te pakten 120 Hz per spektra dhe sinjalet; **27-** Drifti me pak se 0.5 x 10⁻³ AU/h; **28-** Dedektori duhet të ketë mundesi identifikimi automatik për qelizen e prurjes dhe per llampen (RFID) Lineariteti me shume se 2 AU ne 265nm; **29-** Softëare dhe aparatura e HPLC duhet të jetë nga i njëjti prodhues; **30-** Një PC dhe printer duhet të kontrollojë të gjithë modulet dhe të bëjë procesimin e të dhënave si, identifikimin e pikut, analizimin e të dhënave, kalibrimin, kuantifikimin dhe raportimin/ose ekuivalenti këtyre të dhënave; **Për artikullin me nr 22. Kape kimike nuk plotëson specifikimet teknike si 1- Gjerësia 1100 mm - 1200 mm; 2- Kapaciteti thithës mbi 1700 m³/ore; 3- Syprina e punës me material antiacid; 4- Suporti i jashtem me strukture prej celiku te galvanizuar; 5- Pajisur me lavaman me material celik inoks te integruar ne syprinën e punës; 6- Pajisur me rubinet uji; 7- Pajisur me te pakten 2 priza elektrike; 8- Kabina duhet te kete ndricim; 9- Pjesa ballore me xham sigurie te lëvizshëm, te laminuar te pakten 5mm; Ndërsa për artikullin me nr. 35. Furre Mufel nuk plotëson specifikimet teknike si 1- Fuqia: maksimalisht 3kë; 2- Koha e procesit: 1 minute - 99 ore 59 min; 3- Termoelementi duhet te jete Ni – Cr Ni; 4- Kontrolli i temperatures te mundesohet me PID Dixhital kontrolli”, KPP nga verifikimi i katalogëve të ngarkuar në SPE konkretisht “Katalog 20 Thermo Scientific. Pdf”, për pajisjen me nr. 20 HPLC Ëith autosampler, DAD nga prodhuesi Thermo Fisher Scientific, “Katalog 22 Equiplabo. Pdf” për pajisjen me nr. 22 Kape Kimike nga prodhuesi Equiplabo, “Katalog 35 Snol. Pdf” për pajisjen me nr. 35 Furrë Mufel nga prodhuesi Snol, konstaton, se për secilin artikull të mësipërm, operatori ekonomik “Krijon” SHPK, ka markuar në katalogun përkatës specifikimet teknike, të cilat janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Por për një gjykim sa më të drejtë dhe transparent të ankesës dhe për shkak të specifikës së kësaj procedurë prokurimi dhe vështirësisë në evidentimin e mënyrës së përmbushjes së specifikimeve teknike për artikullujt me nr. 20, 22 dhe 35, KPP në datën 15.03.2023, ora 12:30, në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik, zhvilloi një Seancë Dëgjimore midis operatorit ekonomik “Krijon” SHPK, përfaqësuesve të autoritetit kontraktor (anëtar i komisionit të vlerësimit të ofertave, njësisë së prokurimit dhe komisionit shqyrtimit të ankesave dhe anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik, ku për përfaqësuesin e operatorit ekonomik në prani dhe të përfaqësuesve të autoritetit kontraktor nga ana e KPP u shtruan pyetjet se në cilën faqe të katalogut të ngarkuar në SPE nga ana juaj plotësohen specifikimet teknike për të cilat ngrihen pretendime nga operatori ekonomik ankimes për produktin me nr. rendor 20 HPLC With autosampler, DAD, **Përfaqësuesi i operatorit ekonomik z. P. Z sqaron se: Specifikimi****

teknike për artikullin me nr rendor 20 HPLC With autosampler, DAD, në katalogun e dorëzuar nga ana jonë në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific por dhe shpjegimet e paraqitura nga ana jonë sipas kërkesës tuaj evidentohen në këto faqe në katalog konkretisht:

- 1-** Pompa duhet te kete degazues te integruar me të paktën 4 kanale, ky specifikim gjëndet në faqen 3 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific.
- 2-** Diapazoni i prurjes: të paktën 0.001- 10mL/min, ky specifikim gjëndet në faqen 3 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific.
- 3-** Precizioni ≤ 0.07 % RSD, ky specifikim gjëndet në faqen 3 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific.
- 4-** Saktësia e prurjes të paktën $\pm 1\%$, ky specifikim gjëndet në faqen 3 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific.
- 5-** Moduli të punojë me presion më shumë se 580 bar, ky specifikim gjëndet në faqen 3 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific, nga 580 bar të kërkuar presioni i pajisjes tonë arrin deri në 700 bar.
- 6-** Formimi i gradientit të bëhet me anë të përzjerjes në presion të ulët, ky specifikim gjëndet në faqen 3 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific.
- 7-** Kontrolli i çdo përbërësi të prurjes të ketë diapazon 0-100%, ky specifikim gjëndet në faqen 8, paragrafi 2 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific.
- 8-** Pompë Kuaternare me dual piston ne seri, ky specifikim gjëndet në faqen 3 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific.
- 9-** Saktësia e përberjes së prurjes < 0.2 % RSD, ky specifikim gjëndet në faqen 3 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific. Ku nga < 0.2 % RSD, produkti ynë e ka < 0.15 % RSD.
- 10-** Kompensimi i shtypjes te kete mundesi per tu zgjedhur nga perdoruesi Ph i rekomanduar 1-12.5, ky specifikim gjëndet në faqen 3 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific. Ku nga 1-12.5, produkti ynë e ka 1-13.
- 11-** Kapaciteti i autosamplerit >200 viale nga 2 ml, ky specifikim gjëndet në faqen 10 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific.
- 12-** Diapazoni i volumit të injektimit: 0.1-100uL, ky specifikim gjëndet në faqen 10 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific.
- 13-** Carry Over: më pak se 0.003%, ky specifikim gjëndet në faqen 10 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific, ku nga 0.003 % të kërkuar nga AK, ne kemi ofertuar produktin me specifikim 0.002%.
- 14-** Moduli të punojë me presion deri në 800 bar, ky specifikim gjëndet në faqen 10 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific, ku nga 800 bar të kërkuar nga AK, ne kemi ofertuar produktin me specifikim nga 20 bar deri në 1034 bar.
- 15-** Koha e ciklit të injektimit $<10s$, ky specifikim gjëndet në faqen 10 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific, ku nga $<10s$, të kërkuar nga AK, ne kemi ofertuar produktin me specifikim 8 s.
- 16-** Precizioni i injektimit më pak se 0.15% RSD, ky specifikim gjëndet në faqen 10 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific, ku nga 0.15% RSD, të kërkuar nga AK, ne kemi ofertuar produktin me specifikim $<0.25\%$ area RSD.
- 17-** Moduli të ketë kapacitet për 4 kolona nga 300 mm, ky specifikim gjëndet në faqen 13 dhe 14 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific.
- 18-** Diapazoni i temperaturës: $10^{\circ}C$ nën ambient deri ne $85^{\circ}C$, ky specifikim gjëndet në faqen 14 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific, ku nga 10 grade C – 85 grade C, të kërkuar nga AK, ne kemi ofertuar produktin me specifikim 5 grade C – 85 grade C.
- 19-** Me 2 zona temperature, ky specifikim gjëndet në faqen 14 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific, ku nga 2 zona të kërkuar nga AK, ne kemi ofertuar produktin me specifikim me 3 zona temperature.
- 20-** Saktësia e

temperaturës: $\pm 0.5^{\circ}\text{C}$, ky specifikim gjëndet në faqen 14 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific. **21-** Stabiliteti i temperaturës: $\pm 0.1^{\circ}\text{C}$ ose me i mire, ky specifikim gjëndet në faqen 14 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific, ku nga $\pm 0.1^{\circ}\text{C}$ të kërkuar nga AK, ne kemi ofertuar produktin me specifikim $\pm 0.05^{\circ}\text{C}$. **22-** Koha e ngrohjes: < 6 min nga ambienti në 40°C , ky specifikim gjëndet në faqen 14 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific, ku nga < 6 min nga ambienti në 40°C të kërkuar nga AK, ne kemi ofertuar produktin me specifikim nga $25^{\circ}\text{C} - 40^{\circ}\text{C}$ për 5 min. **23-** Moduli të vijë i shoqëruar me një valvul 2 pozicione / 6 porta, ky specifikim gjëndet në faqen 14 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific. **24-** Dedektori duhet të ketë qelize matje 10 mm, ky specifikim gjëndet në faqen 19 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific. **25-** Diapazoni i gjatësisë së vales 190-640 nm ose me mire, ky specifikim gjëndet në faqen 17 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific, ku nga 190-640 nm të kërkuar nga AK, ne kemi ofertuar produktin me specifikim nga 190-680 nm. **26-** Zhurma për qelize matje 10mm më e vogël se $\pm 3.2 \times 10^{-6}$, ky specifikim gjëndet në faqen 17 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific, ku nga $\pm 3.2 \times 10^{-6}$ të kërkuar nga AK, ne kemi ofertuar produktin me specifikim $< \pm 3$ AU në 230 nm. **27-** Dedektori duhet të ketë 1024-elemente diode me 8 sinjale, ky specifikim gjëndet në faqen 17, të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific. **28-** Data rate të jetë te pakten 120Hz per spektra dhe sinjalet, ky specifikim gjëndet në faqen 17 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific, ku nga 120 Hz të kërkuar nga AK, ne kemi ofertuar produktin me specifikim deri në 200 Hz. **29-** Drifti me pak se 0.5×10^{-3} AU/h, ky specifikim gjëndet në faqen 17 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific, ku nga 0.5×10^{-3} AU/h të kërkuar nga AK, ne kemi ofertuar produktin me specifikim < 0.5 mAU/h në 230 nm. **30-** Dedektori duhet të ketë mundësi identifikimi automatik për qelizen e prurjes dhe per llampen (RFID) Lineariteti me shume se 2 AU ne 265 nm, ky specifikim gjëndet në faqen 17 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific, ku nga 2 AU ne 265 nm të kërkuar nga AK, ne kemi ofertuar produktin me specifikim $< 5\%$ në 2.0 AU. **31-** Softëare dhe aparatura e HPLC duhet të jetë nga i njëjti prodhues, ky specifikim gjëndet në faqen 17, të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific. **32-** Një PC dhe printer duhet të kontrollojë të gjithë modulet dhe të bëjë procesimin e të dhënave si, identifikimin e pikut, analizimin e të dhënave, kalibrimin, kuantifikimin dhe raportimin/ose ekuivalenti këtyre të dhënave, ky specifikim gjëndet në faqen 17, të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 20 Thermo scientific. **KPP pyet OE:** Në cilën faqe të katalogut të ngarkuar në SPE nga ana juaj plotësohen specifikimet teknike për të cilat ngrihen pretendime nga operatori ekonomik ankimes për produktin me nr rendor 22 Kape Kimike, **Përfaqësuesi i operatorit ekonomik z. P. Z sqaron se:** Specifikimi teknike për artikullin me nr rendor 22 Kapë Kimike, në katalogun e dorëzuar nga ana jonë në SPE me emërtesën 22 Equiplabo por dhe shpjegimet e paraqitura nga ana jonë sipas kërkesës tuaj evidentohen në këto faqe në katalog konkretisht: **1-** Gjerësia 1100 mm - 1200 mm, ky specifikim gjëndet në faqen 8, të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 22 Equiplabo. **2-** Kapaciteti thithës mbi 1700 m³/ore, ky specifikim gjëndet në faqen 13, të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 22 Equiplabo. **3-** Syprina e punës me material antiacid, ky specifikim gjëndet në faqen 1 dhe 19 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 22 Equiplabo. **4-** Suporti i jashtëm me

strukture prej celiku te galvanizuar, ky specifikim gjendet në faqen 1, 9 dhe 19 të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 22 Equiplabo. **5-** Pajisur me lavaman me material celik inoks te integruar ne syprinën e punës, ky specifikim gjendet në faqen 1, 9 dhe 19, të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 22 Equiplabo. **6-** Pajisur me rubinet uji, ky specifikim gjendet në faqen 15 dhe 16, të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 22 Equiplabo. **7-** Pajisur me te pakten 2 priza elektrike, ky specifikim gjendet në faqen 17, të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 22 Equiplabo. **8-** Kabina duhet te kete ndricim, ky specifikim gjendet në faqen 3 dhe 4, të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 22 Equiplabo. **9-** Pjesa ballore me xham sigurie te lëvizshëm, te laminuar te pakten 5mm, ky specifikim gjendet në faqen 1, të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 22 Equiplabo. **KPP pyet OE:** Në cilën faqe të katalogut të ngarkuar në SPE nga ana juaj plotësohen specifikimet teknike për të cilat ngrihen pretendime nga operatori ekonomik ankimues për produktin me nr rendor 35 Furrë Mufel, **Përfaqësuesi i operatorit ekonomik z. P. Z sqaron se:** Specifikimi teknike për artikullin me nr rendor 35 Furrë Mufel, në katalogun e dorëzuar nga ana jonë në SPE me emërtesën 35 Snol por dhe shpjegimet e paraqitura nga ana jonë sipas kërkesës tuaj evidentohen në këto faqe në katalog konkretisht: **1-** Fuqia: maksimalisht 3kë, ky specifikim gjendet në faqen 3, të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 35 Snol. **2-** Koha e procesit: 1 minute - 99 ore 59 min, ky specifikim gjendet në faqen 11, të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 35 Snol. **3-** Termoelementi duhet te jete Ni – Cr Ni, ky specifikim gjendet në faqen 5, të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 35 Snol. **4-** Kontrolli i temperatures te mundesohet me PID Dixhital kontrolli, ky specifikim gjendet në faqen 8, të katalogut të ngarkuar në SPE me emërtesën 35 Snol. Sa më sipër, KPP nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, verifikimi i katalogëve të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Krijon” SHPK, sqarimeve dhe argumenteve të dorëzuara nga ky i fundit pranë KPP, si dhe deklarimeve të tij në seancën degjimore të mbajtur në datë 15.03.2023, gjykon, se operatori ekonomik “Krijon” SHPK përmbush specifikimet teknike në lidhje me artikujt nr. 20, 22 dhe 35. Gjithashtu, vlen të theksojmë, se edhe specialistët e autoritetit kontraktor prezentë gjatë seancës degjimore znj. S. H, znj. M. D dhe znj. Z. C, deklaruan dhe evidentuan specifikimet teknike në katalogun e dorëzuar nga operatori ekonomik “Krijon” SHPK. Sa më sipër argumentuar, gjykojmë, se operatori ekonomik “Krijon” SHPK me anë të dokumentacionit të paraqitur vërteton, se artikujt e ofruar nga ky i fundit janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor.

III.4.16. Vlen të theksojmë, se autoriteti kontraktor disponon të gjitha elementet e nevojshme procedurale, si garanci, në rast të shkeljes së kontratës, konkretisht nenin 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 36 “Sigurimi i kontratës”, dhe nenin 108 “Raportimi në rastet e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se në bazë të nenit 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës” të LPP-së, si dhe nenit 36 “Sigurimi i kontratës”, dhe nenit 108 “Raportimi në rastet e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për

realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit do të jetë e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të ligjit dhe rregullave për prokurimin publik, si më sipër cituar. Operatori ekonomik “Krijon” SHPK, me anë të dokumentacionit të paraqitur, vërteton se plotëson me sukses specifikimet teknike për produktet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në dokumentet standarde të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Almedical” SHPK vetëm për pretendimet mbi operatorin ekonomik “Medfau” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-43070-09-23-2022, me objekt “Blerje pajisje laboratorit për Autoritetin Kombëtar të Ushqimit”, me fond limit 46,795,767 (dyzetë e gjashtë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH ose 401,198 (katërqind e një mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tetë) euro pa TVSH, kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 22.09.2022 është 116.64 lekë), zhvilluar në datën 12-12-2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Medfau” SHPK, si dhe të korrigjojë shkeljet duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Almedical” SHPK për pretendimet mbi operatorët ekonomikë “Isometric” SHPK dhe “Krijon” SHPK në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.
4. Të mos marrë në shqyrtim pretendimet e operatorit ekonomik ankimes për operatorin ekonomik “Gamma” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

5. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 6. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Almedical*” SHPK.
 7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri